

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6025  
E shtunë, 14 mars 2020  
çmimi 0.40 €

Nga gjithsej 4 694  
zyrtarë, vetëm 676  
prej tyre e kanë  
deklaruar pasurinë



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

TË PREMTEN JANË KONFIRMUAR DY RASTET E PARA  
ME KORONAVIRUS NË KOSOVË | FAQE 3

## KORONAVIRUSI PREK EDHE KOSOVËN

Në Kosovë janë konfirmuar të premten dy rastet e para me koronavirus. Lajmi është bërë me dije të premten në një konferencë për media nga ministri i Shëndetësisë, Arbën Vitia, i cili ishte i shoqëruar edhe nga kryeministri Albin Kurti. Ministri Vitia ka thënë se pacientet e konfirmuara janë: njëra shtetase italiane, e moshës 20-vjeçare, tjetra shtetase e Kosovës, e moshës 77-vjeçare. Ai ka bërë me dije se gjendja e të infektuarve është stabile. Qeveria e Kosovës ka miratuar planin për reagim lidhur me koronavirusin, ku përfshihet një buxhet prej 10 milionë eurosh



Foto: Reuters / Ilustrim

### OPINION

**IDENË E BASHKIMIT  
KOMBËTAR NUK MUND TA  
DEKONSTRUKTOJË ASKUSH**

F. 11

Shkruan: Jakup  
KRASNIQI



### AKTUALE

**BAHTIRI KËRKON NGA RAKIQI  
MOS T'I PENGOJË PUNIMET  
PRANË LUMIT IBËR**

F. 7

**AMBASADORI KOSNETT  
KONFIRMON PËRKRAHJEN  
PËR FSK-në**

F. 5



### EKONOMI

**KËRKOHEM SHTYRJE  
E AFATEVE BIZNESORE  
NGA BANKAT DHE ZRRË-ja**

F. 9

**BIE NUMRI I DENONCIMEVE  
PËR KEQPËRDORIM  
TË ÇMIMEVE**

F. 8

### KULTURË

**BASHKËPUNIMI PËR  
TË RINJTË E KOSOVËS,  
PRIORITET PËR MKRS-NË,  
UNFPA-NË E UNKT-në**

F. 7

TË PREMTEN U TAKUAN PRESIDENTI HASHIM THAÇI DHE KRYEMINISTRI ALBIN KURTI

## TAKIMI SUBSTANCIAL I THAÇI DHE KURTIT



Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Albin Kurti për dy orë kanë biseduar të premten për politikën e brendshme dhe atë të jashtme të Kosovës. Të dytë takimin e kanë vlerësuar substancial, të hapur dhe pozitiv për vendin. Presidenti Thaçi, i cili e kishte ftuar këtë takim, ka thënë se Kosova në bisedimet me Serbinë do të jetë unike. Ndërsa kryeministri Kurti ka thënë se me shëfën e shtetit kanë biseduar për shumë tema të rëndësishme. Presidenti dhe kryeministri kanë bërë me dije se takimet e tilla do t'i vazhdojnë | FAQE 4-5

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Partitë në Maqedoninë Veriore dorëzojnë listat me kandidatët për zgjedhjet e 12 prillit

Beteja në zgjedhjet e 12 prillit do të zhvillohet mes katër blloqeve politike, dy në bllokun maqedonas dhe dy në atë shqiptar. LSDM dhe VMRO DPMNE-ja synojnë fitore sikur edhe BDI-ja dhe koalicioni opozitar shqiptar mes Aleancës për Shqiptarët dhe Alternativës



**SHKUP, 13 MARS** – Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Maqedoninë Veriore më 12 prill do të marrin pjesë 15 parti politike dhe koalicione me 1598 kandidatë të mundshëm për përbërjen e ardhshme parlamentare që numëron 120 deputetë, ka bërë të ditur Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Afati për dorëzimin e listave me kandidatë ka skaduar të enjten në mesnatë ndërsa KSHZ-ja ka 24 orë afat për të kontrolluar nëse ndonjëra nga partitë ka lëshime në përmbushjen e kriterëve për të marrë pjesë në zgjedhje.

Fushata elektorale duhet të fillojë më 23 mars, por për shkak të gjendjes me koronavirusin nuk përjashtohet mundësia që ajo të anulohet apo të zhvillohen në forma tjera, kryesisht nëpërmjet media dhe rrjete sociale, ka njoftuar rfe.

Këtë e kanë paralajmëruar vetë drejtuesit e partive të enjten në një takim me kryeministrin, Oliver Spasovski në të cilin kanë diskutuar për gjendjen me virusin Covid-19.

Për momentin nuk ka ndonjë

vendim për shtyrjen e zgjedhjeve. Beteja në zgjedhje do të zhvillohet mes katër blloqeve politike, dy në bllokun maqedonas dhe dy në atë shqiptar. LSDM dhe VMRO DPMNE-ja synojnë fitore sikur edhe BDI-ja dhe koalicioni opozitar shqiptar mes Aleancës për Shqiptarët dhe Alternativës.

Kreu i Lidhjes-Socialdemokrate, Zoran Zaev pret fitore në zgjedhjet e 12 prillit, madje pritet e tij janë që të marrë 61 deputetë apo gjysmën e përbërjes parlamentare, që të mos kushtëzohet, siç thotë, nga partitë e tjera.

“Ky është qëllimi dhe ambicia jonë, por populli është ai që do të vendos se cilin opSION do të votojë. Me 61 deputetë formohet qeveria, por na duhet formacion stabil sepse në periudhën që vjen kemi shumë punë. BE-ja dhe NATO-ja kaluan, u bënë. Problemet me Bullgarinë dhe Greqinë u zgjidhën. Tash jemi të bashkuar brenda. Duhet të punojmë që brenda të kemi rregull, ligje të zbatueshme, kriterë në punë”, tha kryetari i

LSDM-së, Zoran Zaevi.

Kjo parti në zgjedhje merr pjesë me disa parti të bashkësive tjera etnike, përfshirë edhe Lëvizjen Besa, që është partia e parë në historinë e pluralizimit që hyn në koalicion parazgjedhor me një parti maqedonase.

Fitore në zgjedhje pret edhe opozita maqedonase. VMRO DPMNE-ja, e cila udhëheq bllokun opozitar prej disa partive më të vogla.

“Po hyjmë në finalen e një beteje shumë të rëndësishme për Maqedoninë, kjo është një beteje vlerash dhe parimesh, një beteje thelbësore dhe një gjeneratë e re që duhet të luftojë për drejtësi, liri dhe një të ardhme më të mirë. Fitorja jonë është fitore për rindërtimin e vendit.

Rimëkëmbja që do të sjellë më shumë për të gjithë, më shumë drejtësi, më shumë vlera, më shumë parime, punë, më shumë para, më shumë shëndet, më shumë lumturi, rend, siguri dhe buzëqeshje në fytyrat e qytetarëve tanë dhe besim se do të kemi sukses”, ka deklaruar kryetari i VMRO DPMNE-së, Hristijan Mickovski.

Edhe Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI) pret të jetë fituese e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në bllokun shqiptar dhe ta realizojë siç thotë një nga fitoret më të mëdha në ekzistimin e saj politik.

“Qytetarët e kanë të qartë se BDI-ja është parti e cila ka rezultate, ka vizion dhe konsistencë. Mund të vonojë, por gjithmonë ka

rezultate. Në BDI veçanërisht shqiptarët e shohin interesin e tyre edhe për shkak të historisë edhe për shkak të listës së çështjeve të cilat i ka gjatë gjithë mandatit. Prandaj jemi absolutisht të bindur se kjo do të jetë një prej fitoreve më të mëdha të BDI-së”, ka deklaruar zëdhënësi i BDI-së, Bujar Osmani.

Drejtuesit e koalicionit opozitar shqiptar besojnë se zgjedhjet e 12 prillit sipas tyre, do t’ua kthejnë shqiptarëve dinjitetin e nëpërkëmbur nga pushteti aktual, në veçanti nga BDI-ja të cilën e fajësojnë për moszgjidhjen e çështjeve kryesore të shqiptarëve.

Fushata për zgjedhjet e 12 prillit do të zgjasë 20 ditë.

## Qeveria holandeze propozon çeljen e negociatave me kusht

**TIRANË, 13 MARS** - Zbulohet qëndrimi i Qeverisë së Holandës dërguar Parlamentit më lidhje me çeljen e negociatave mes Shqipërisë dhe BE-së.

“Qeveria holandeze e ka marrë raportin e Komisionit Evropian. Sikurse shprehet edhe në raport, Shqipëria është në binarët e duhur. Është bërë progres i prekshëm në fushën e reformave. Nga ana tjetër, ka ende një sërë çështjesh që kërkojnë vëmendje”, thuhet në letrën dërguar parlamentit, ka njoftuar Top Channel.

“Në princip qeveria jonë mbështet rekomandimin e Komisionit Evropian për çeljen e negociatave me Shqipërinë. Megjithatë negociatat në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të BE-së me Shqipërinë në këndvështrimin tonë nuk mund të fillojnë pa u

vërejtur progres i mëtijshëm në kushtet e vendosura nga Këshilli në 2018 në mënyrë të posaçme për procesin e vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe themelimin e strukturave të pavarura të drejtësisë sipas reformës në drejtësi përfshi finalizimin e SPAK dhe BKH bashkë me gjykatat përkatëse. Kjo duhet të shoqërohet me thellimin e rasteve të shënuara me hetime dhe ndëshkime konkrete në luftën me krimin e organizuar dhe korrupsionin në nivele të larta”, është një nga kërkesat e Qeverisë holandeze.

“Për këtë arsye, Qeveria holandeze bie dakord për hapjen e negociatave dhe mbajtjen e Këshillit të parë ndërqeveritar, pasi janë plotësuar një sërë kushtesh, sikurse janë bërë të ditura në këtë letër”, thuhet tutje në këtë



letër. Megjithatë, Holanda synon që vendimi kryesor dhe fjala e fundit të merret nga Këshilli më 24 mars 2020.

Pozicioni i Qeverisë holandeze për Mbledhjen e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme (GAC) duhet të diskutohet fillimisht me Parlamentin holandez, e kjo do

të ndodhë më 17 mars 2020. Më pas, diskutimi do të zhvillohet midis vendeve anëtare në mbledhjen e Këshillit të datës 24 mars 2020.

Të premten janë konfirmuar dy rastet e para me koronavirus në Kosovë

# Koronavirusi prek edhe Kosovën

Në Kosovë janë konfirmuar të premten dy rastet e para me koronavirus. Lajmi është bërë me dije të premten në një konferencë për media nga ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, i cili ishte i shoqëruar edhe nga kryeministri Albin Kurti. Ministri Vitia ka thënë se pacientet e konfirmuara janë: njëra shtetase italiane, e moshës 20-vjeçare, e tjetra shtetase e Kosovës, e moshës 77-vjeçare. Ai ka bërë me dije se gjendja e të infektuarve është stabile. Qeveria e Kosovës ka miratuar planin për reagim lidhur me koronavirusin, ku përfshihet një buxhet prej 10 milionë eurosh



Kosovë, Arben Vitia, ka thënë se Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i ka rekomanduar Qeverisë së Kosovës që t'i mbyllë kufijtë e Kosovës për ta parandaluar përhapjen e koronavirusit të ri. "Kemi marrë rekomandim për një kohë të shkurtër të mbylljen kufijtë tokësorë", ka thënë Vitia pas takimit të komisionit të posaçëm për parandalimin e koronavirusit të cilin e udhëheq kryeministri Albin Kurti, i cili ka thënë se në rast se vjen deri te mbyllja e kufirit, atëherë kjo do të vlejë vetëm për qarkullimin e njerëzve e jo për mallra. Shumë vende evropiane kanë mbyllur kufijtë dhe kanë shpallur gjendje emergjente për shkak të përhapjes së koronavirusit.

Qeveria e Kosovës ditën e martë e ka miratuar planin për reagim lidhur me koronavirusin, ku përfshihet një buxhet prej 10 milionë eurosh, i cili thuhet se do të jetë i mjaftueshëm për t'i pajisur të gjitha institucionet shëndetësore, emergjencat si dhe për adaptimin e objekteve për t'i trajtuar rastet që mund të paraqiten. Ky plan fillimisht është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe më pas është tumirë edhe nga Këshilli Kombëtar i Sigurisë.

Arben Vitia, ministër i Shëndetësisë, ka thënë se plani parasheh mbulimin financiar të aktiviteteve të planit të gatishmërisë dhe të reagimit kundër sëmundjes Covid 19 që shkaktohet nga koronavirusi. "Ky plan i përcakton përgjegjësitë e secilit institucion

## Koronavirusi shtyn qytetarët të furnizohen me produkte ushqimore, marketet shtrenjtojnë mallrat

Blerja dhe krijimi i rezervave të produkteve ushqimore, barnave dhe atyre sanitare e higjienike, tashmë është një dukuri që po manifeston frikën dhe panikun e krijuar te shumë qytetarë nga përhapja e koronavirusit. Qytetarët vazhdojnë të furnizohen me ushqime e gjësende të tjera, në

rast se do t'u duhet të izoloohen nëpër shtëpitë e tyre. Duke e parë këtë panik të qytetarëve për t'u furnizuar me ushqime e gjësende të tjera, shumica e marketeve të mëdha kanë ngritur çmimet. Ndaj ngritjes së çmimeve ka pasur reagim nga institucionet e vendit dhe shoqëria civile.

ku, ndër të tjera, do të ketë pajisje për profesionistët shëndetësorë, furnizimin me terapi, pajisjen e karantinave me infrastrukturën e nevojshme, materialet informative për qytetarët, pajisjet laboratorike, krijimin e hapësirave izoluese, ekipet e reagimit të shpejtë dhe dhomat e veçanta", ka sqaruar ai. Në Kosovë deri më 27 mars nuk do të zhvillohet mësimi në universitete, shkolla dhe çerdhe. Ministri i Infrastrukturës, Lumir Abdixhiku, ka bërë me dije se të enjten është marrë vendim që të pezullohen përkohësisht të gjitha fluturimet për zonat me rrezik të mesëm dhe të lartë nga koronavirusi. Abdixhiku përmes një postimi në llogarinë e vet në

"Facebook" ka thënë se janë pezulluar linjat ajrore dhe tokësore për në Gjermani, Francë, Zvicër dhe Itali. Deri më tani me koronavirus janë prekur rreth 117 mijë persona në mbarë botën, ndërkaq kanë vdekur mbi katër mijë. Shumica e rasteve janë raportuar në Kinë, ndërsa shumica e tyre në epiqendrën e shpërthimit - provincën Hubei. Italia është vendi me më së shumti persona të prekur me këtë virus në Evropë, derisa virusi ka arritur edhe në Kroaci, Serbi, Maqedoni të Veriut e Shqipëri. Shenjat kryesore të infektimit me koronavirus janë temperaturë e lartë, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje.

**EPOKA ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 13 MARS** - Në Kosovë janë konfirmuar të premten dy rastet e para me koronavirus. Lajmi është bërë me dije nga ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, në një konferencë të jashtëzakonshme për media, ku ishte i pranishëm edhe kryeministri Albin Kurti. Ministri Vitia ka thënë se 15 raste kanë qenë të dyshuara të premten në Infektivë dhe vetëm dy raste u konfirmuan pozitive. Të dy pacientët janë të shtruar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Ministri Vitia ka thënë se pacientet e konfirmuara janë: njëra shtetase italiane, e moshës 20-vjeçare, tjetra shtetase e Kosovës, e moshës 77-vjeçare. Ai ka thënë se gjendja e të infektuarve është stabile.

Kryeministri Albin Kurti u ka bërë apel qytetarëve që mos bëjnë panik, por me kujdes të

shtuar t'u përmbahen udhëzimeve për parandalimin e koronavirusit. "Ftohen qytetarët që të mos bëjnë panik, por me qetësi dhe kujdes të shtuar t'u përmbahen udhëzimeve për parandalimin e koronavirusit. I ftoj qytetarët për qetësi, që të mos bëjnë panik dhe të mos paraqiten në Klinikën Infektive nëse nuk kanë shenja të sëmundjes", ka thënë Kurti. Edhe presidenti i vendit, Hashim Thaçi, u ka bërë thirrje qytetarëve që t'i ndjekin me përpikëri instruksionet e dhëna nga institucionet tona përgjegjëse. "Kërkoj nga ju që ta menaxhojmë edhe këtë situatë pa panik, në koordinim dhe me kujdes të shtuar për njëri-tjetrin. Ne, së bashku, do t'ia dalim!", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

**IKShPK-ja ka propozuar mbylljen e kufijve**

Ministri i Shëndetësisë në

## Shqipëria mbyll kufirin me Kosovën

Autoritetet në Shqipëri kanë vendosur që në kuadër të masave parandaluese kundër përhapjes së koronavirusit, ta mbyllin përkohësisht edhe kufirin me Kosovën.

Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit (QKMK) që funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Kosovë ka njoftuar se duke filluar nga data 13 mars 2020, në orën 06.00, do të ndalohej hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë për të gjithë shtetasit, përkatesisht veturat e Republikës së Kosovës. "Do të lejohet hyrja vetëm e veturave të shëndetësisë apo ndihmës së shpejtë,

automjeteve komerciale (ato të cilat bartin mallra) dhe veturave qeveritare. Kjo masë do të zgjasë deri më datën 15 mars 2020 në orën 24.00", thuhet në njoftimin e QKMK-së.

Në kuadër të masave shtrënguese që ndalojnë qarkullimin në Shqipëri, qeveria e atjeshme ka marrë masa edhe për ndalimin e qarkullimit të mjeteve publike dhe atyre private në Tiranë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Elbasan, Fier dhe Vlorë. Shqipëria tash për tash ka 33 raste me koronavirus, ndërsa këtë javë ka regjistruar edhe viktimën e parë nga sëmundja që shkakton koronavirusi, COVID-19.

TË PREMTEN U TAKUAN PRESIDENTI HASHIM THAÇI DHE KRYEMINISTRI ALBIN KURTI

# TAKIMI SUBSTANCIAL

Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Albin Kurti për dy orë kanë biseduar të premten për politikën e brendshme dhe atë të jashtme të Kosovës. Të dytë takimin e kanë vlerësuar substancial, të hapur dhe pozitiv për vendin. Presidenti Thaçi, i cili e kishte ftuar këtë takim, ka thënë se Kosova në bisedimet me Serbinë do të jetë unike. Ndërsa kryeministri Kurti ka thënë se me shefin e shtetit kanë biseduar për shumë tema të rëndësishme. Presidenti dhe kryeministri kanë bërë me dije se takimet e tilla do t'i vazhdojnë

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 13 MARS** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri Albin Kurti kanë zhvilluar të premten një takim të gjatë, ku kanë biseduar për reformat e brendshme dhe politikën e jashtme. Pas takimit gati dy orësh ata kanë thënë se biseda mes tyre ishte substanciale, duke u pajtuar që t'i vazhdojnë takimet e tilla. Shefi i shtetit në një konferencë për gazetarë ka thënë se takimi ka qenë shumë i hapur dhe i nevojshëm për të sotmen dhe të ardhmen e vendit. "Konstatoj se takimi ka qenë i gjatë, ka qenë përmbajtësor, shumë i hapur, ku janë diskutuar gjërat për të cilat kemi pasur, besoj këndvështrim konstruktiv. Është diskutuar për çështje të brendshme dhe të politikës së jashtme. Pra, për interesat nacionale, prioritetet nacionale të shtetit të Kosovës dhe qytetarëve të vendit, për reformat që duhet të ndodhin

në vend se të lëvizim më shpejt drejt perspektivës evropiane, për zhvillime dhe mundësi të reja të integritit kombëtar, për rolin dhe fuqizimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare", ka thënë Thaçi.

Ai ka treguar se në këtë takim është folur edhe për dialogun Kosovë - Serbi. "Gjithashtu, edhe për dialogun Kosovë - Serbi ishte konstatim i përbashkët se një punë e përbashkët e bartëseve të institucioneve dhe të liderëve politikë, të pozitës dhe e opozitës, të mund ta çojë vendin më shpejt dhe më mirë përpara. Mendoj se ka hapësirë dhe substancë të mjaftueshme, sepse ka më tepër gjëra që na përafrojnë sesa që na ndajnë për të çuar vendin në NATO, BE dhe për ta ruajtur miqësinë me ShBA-në", ka thënë Thaçi.

Më tej, ai ka thënë se në ditët në vijim do t'i drejtohet edhe Kuvendit të Kosovës për takimin e tij në Shtëpinë e Bardhë me presidentin serb Aleksander Vuçiq. "Theksoj se



takimi në Shtëpinë e Bardhë ka qenë një takim i një rëndësie të veçantë dhe historike, që mund t'i hapë perspektivë arritjes së një marrëveshje përfundimtare me njohje reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë. Unë shpresoj se qeveria do të marrë vendime të shpejta dhe të qarta dhe në kohën e duhur", është shprehur presidenti. Shefi i shtetit ka vlerësuar se Kosova në tavolinën e bisedimeve do të jetë unike. "Në tavolinë do të jemi të bashkuar si Kosovë, me një qëndrim, me qëndrimin e ruajtjes dhe kultivimit të forcimit të interesit shtetëror dhe perspektivës euroatlantike. Prandaj, duhet të fokusohemi në gjërat që janë përafuese mes neve. Interesi nacional është mbi të gjitha", ka thënë Thaçi. Edhe kryeministri Albin Kurti e

ka vlerësuar substancial takimin me presidentin. "Takimi ka hapur një mori temash, prej minishengenit tek aleanca ballkanike. Prej pozitës, opozitës deri te dialogu, e tarifa, e Uashingtoni", ka thënë Kurti në konferencën e jashtëzakonshme për media. Ai ka deklaruar se takimet e tilla janë të nevojshme për koordinimin e politikave. "Ka qenë një takim si lajm i mirë për Kosovën, meqenëse presidenti e kryeministri duhet të takohen. Ka qenë takim substancial edhe pse nuk është menduar si i tillë. Dhe do të vazhdojë, që të mos ketë befasi dhe paprashikueshmëri", ka thënë Kurti. Ky takim mes presidenti dhe kryeministrit ka ndodhur pas disa përpjekjeve të dështuara për të realizuar atë.

# I THAÇI DHE KURTIT



## KURTI: PËRDERISA S'KEMI NJË VENDIM TË RI, TAKSA MBETET NË FUQI

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se përderisa nuk ka një vendim të ri qeveritar lidhur me atë se si duhet vepruar, taksa 100 për qind e vendosur ndaj produkteve që vijnë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina mbetet në fuqi. "Taksa ngelet në fuqi. Më së miri do të ishte që të kishim një vendim qeveritar për ta hequr taksën për lëndën e parë, por jemi këtu ku jemi dhe përderisa

nuk kemi ndonjë vendim të ri, ngelet ai i vjetri", ka thënë Kurti. Ai ka thënë se është duke zhvilluar takime të rregullta me kryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafën, për të diskutuar rreth kësaj çështje. "Po, ne kemi takime të rregullta si dy krerë të subjekteve politike dhe natyrisht se qëllimet i kemi të përbashkëta. Jemi bashkë në qeveri, por kjo s'do të thotë se nuk kemi dallime", ka deklaruar ai, duke shtuar se kur të arrijnë një pajtim me partnerin e koalicionit këtë çështje do ta sjellë në qeveri për votim. "Ne vazhdojmë të besojmë se kur ta kemi një pajtim lidhur me taksën, atëherë edhe do të mund ta bënim vendim të qeverisë në mënyrë që të mos jetë një vendim me shumicë të thjeshtë. Nuk mund t'ju them ndonjë gjë të re sepse nuk ka ndonjë zhvillim të ri", ka deklaruar ai.

## Kryeziu: LDK-ja ta pranojë propozimin e Kurtit për heqje të pjesshme të taksës

Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se LDK-ja duhet ta pranojë propozimin e Kurtit për heqje të pjesshme të taksës. Kryeziu ka thënë se meqenëse LDK-ja si pjesë e koalicionit qeverisës nuk ka mundur të ndikojë në qëndrimet e kryeministrit,

atëherë le ta pranojë këtë propozim. "LDK-ja si pjesë e koalicionit qeverisës, mbase s'ka mundur ta ndikojë në qëndrimin e kryeministrit për heqjen e taksës si ka propozuar kjo parti. Atëherë, do të duhej që ta pranojë propozimin e kryeministrit Kurti, edhe të mundësojë që

sot ose nesër qeveria ta marrë vendimin e propozuar për 15 mars. 15 marsi e 1 prilli janë dy javë. As në kohë e as në përmbajtje s'përbëjnë kurrfarë ndryshimi nga propozimet për heqje të tërësishme të taksës", ka shkruar Kryeziu në llogarinë e vet në "Facebook".

## Ambasadori Kosnett konfirmon përkrahjen për FSK-në

PRISHTINË, 13 MARS (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, ka pritur të premten ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, duke i uruar mirëseardhje dhe shprehur falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për ShBA-në në mbështetjen e pazëvendësueshme të ofruar deri më tani në të gjitha periudhat historike të vendit dhe popullit tonë si dhe në ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e gjithëmbarshtëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

Ministri Quni ka theksuar se mbështetja e deritashme në trajnime, shkollime, mbështetje logjistike dhe forma të tjera e ofruar nga ShBA-ja ka qenë jetike në ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e kadrove profesionale dhe ndikim të lartë në realizimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale kompatible dhe interoperabile me forcat aleate të vendeve partnere dhe anëtare të NATO-s dhe vetë forcat ushtarake amerikane. Ai ka shprehur gatishmërinë dhe vullnetin e plotë që FSK-ja me njësitë e saj të angazhohet në operacionet paqeruajtëse bashkë me forcat amerikane. Ministri Quni e njoftoi ambasadorin Kosnett edhe me procesin e implementimit të planit gjithëpërfshirës të tranzicionit duke ritheksuar se ky proces, si deri më tani, do të realizohet në transparencë të plotë dhe përputhje me kornizën kohore të planifikuar si dhe në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me vendet partnere e posaçërisht me ShBA-në. Ai ka ritheksuar edhe një herë se FSK-ja është dhe do të jetë forcë bashkëkohore me



vlera dhe standarde të vendeve të NATO-s nën kontrollin civil demokratik dhe gjithnjë në shërbim të paqes, stabilitetit dhe sigurisë rajonale dhe më gjerë.

Nga ana e tij, ambasadori Kosnett premtoi se ShBA-ja përmes Programit Shtetëror të Partnershipit me Gardën Kombëtare të Ajovës dhe programeve të tjera, sikur edhe deri më tash, do ta vazhdojë partneritetin me Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në në mënyrë që t'i përmbushë me sukses të plotë synimet e tyre, respektivisht procesin e tranzicionit sipas planit përkatës. Ambasadori Kosnett, ndër të tjera, ka shprehur edhe interesimin për projektin e shërbimit të obligueshëm ushtarak, për të cilin ministri Quni e informoi nga këndvështrimi profesional duke theksuar rëndësinë e këtij projekti; nga dimensionet

edukativ, arsimor, social, ndërkomunikues, integruar dhe kultivimin e vlerave të mëdha që ka diversiteti kulturor, etnik dhe fetar i vendit për gjeneratat e reja.

Ai në fund theksoi se ky projekt tanimë është pjesë e programit qeverisës dhe do të analizohet dhe vlerësohet nga ekspertët të të gjitha fushave nga institucionet akademike, institucionet ndërkombëtare, shoqëria civile, organizata të ekspertëve dhe strukturat profesionale tona ushtarake gjithnjë në transparencë dhe bashkërendim të plotë me partnerët tanë. Ky projekt, shtoi ai, nuk e cenon procesin e tranzicionit dhe statusin e FSK-së si forcë profesionale. Në fund, të dy ishin të një qëndrimi që të shtohet edhe më tej bashkëpunimi bilateral në mes dy vendeve mike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

# Reka: Kosova ka plotësuar të gjitha kriteret për liberalizim të vizave

PRISHTINË, 13 MARS (ER) - Ministri i Integritimit Evropian, Blerim Reka, ka pritur të premtën në takim ambasadoren e Suedisë në Kosovë, Karin Hernmarck, me të cilën ka diskutuar për marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve tona dhe prioritetet me agjendën evropiane. Me këtë rast ministri Reka vlerësoi përkrahjen e vazhdueshme të Suedisë si përdërtimin e institucioneve demokratike të Kosovës, po ashtu edhe për anëtarësimin në organizata rajonale dhe ndërkombëtare. Ministri Reka i bëri thirrje ambasadores Hernmarck që kjo përkrahje të

vazhdojë dhe të jetë më e strukturuar në mënyrë që edhe ndikimi të jetë më i madh në rrugën e Kosovës drejt integritimit në BE dhe sidomos në liberalizimin e vizave.

Njëkohësisht, ministri Reka ka thënë se Kosova ka plotësuar të gjitha kriteret për ta pranuar liberalizimin e vizave, prandaj edhe zëri përkrahës i Suedisë do të ishte më se i mirëseardhur në këtë kohë, posaçërisht duke pasur në mendje samitin që do të mbahet në Zagreb në muajin maj.

Nga ana e saj ambasadorja Hernmarck vuri në pah



përkushtimin dhe entuziazmin e Kosovës për të avancuar sa më

shumë agjendën evropiane dhe shpreson që periudha në vijim do

të jetë në anën e Kosovës për ta konkretizuar si lëvizjen e lirë për qytetarët, ashtu edhe avancimet me MSA-në dhe ERA. Po ashtu, ambasadorja theksoi se Suedia do ta mbështesë arritjen e aspiratave të qytetarëve të Kosovës drejt familjes evropiane. Njëkohësisht ritheksoi se Suedia qëndron krah qytetarëve të Kosovës në rrugën drejt integritimit në BE. Në fund, ajo theksoi se së shpejti do të mbahet takimi vjetor në mes të Suedisë dhe Republikës së Kosovës si dhe se janë në përgatitje të strategjisë së re që adreson reformat për bashkëpunim.

## Italia i dhuron pajisje mbrojtëse personale Institutit Kombëtar

PRISHTINË, 13 MARS (ER) - Në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike është mbajtur ceremonia e dhurimit të pajisjeve personale mbrojtëse për personelin shëndetësor, në Departamentin e Mikrobiologjisë, për ta parandaluar koronavirusin. Drejtori ekzekutiv i Institutit Kombëtar, Naser Ramadani, u shpreh mirënjohës ndaj ambasadorit italian Nicola

Orlando, duke thënë se ky është një donacion me rëndësi shumë të madhe, në këtë kohë kaq të vështirë që, sipas tij, edhe pse momentalisht nuk kemi asnjë rast të konfirmuar në Kosovë, të jemi të mbrojtur nga ekspozimi ndaj kësaj sëmundje.

Ndërkaq ambasadori i Italisë, Nicola Orlando, ka thënë se situata në Itali është e vështirë, ndërsa theksoi se është e

rëndësishme që ta izolojmë së pari veten, në mënyrë që t'i mbrojmë të tjerët.

Shefi i Departamentit të Mikrobiologjisë në IKShPK, Xhevat Jakupi, e falënderoi ambasadorin italian dhe tha se në Departamentin e Mikrobiologjisë tashmë po bëhet testimi për COVID-19. Ai shtoi se këto pajisje personale mbrojtëse janë dhuruar në kohën e qëlluar.



## Bashkësisë Islame dhe Kisha Katolike marrin masa ndaj koronavirusit

PRISHTINË, 13 MARS (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka zhvilluar të premtën takime të ndara me krerët e bashkësive fetare në Kosovë, respektivisht me myftiun e Bashkësisë Islame në Kosovë, Naim Tërnavë dhe me Ispeshkvin e Kishës Katolike në Kosovë, Imzot Dodë Gjergji. Në takimin me kreun e Bashkësisë Islame, myftiun Naim Tërnavë, ministri Vitia e njoftoi për së afërmi me masat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës dhe me rekomandimin e Ministrisë së Shëndetësisë për mbrojtjen e shëndetit publik. "Jemi në gjendje gatishmërie. Janë marrë një seri e masave preventive ndaj virusit të panjohur deri më tani, Covid-19", ka thënë ministri Vitia.

Në këtë takim u tha se është obligim moral, kombëtar dhe fetar i gjithsecilit që të japë kontributin për tejkalimin e kësaj



gjendjeje, e cila paraqet shqetësim për të gjitha vendet.

Myftiu Naim Tërnavë ka deklaruar se Bashkësia Islame e Kosovës tashmë ka bërë thirrje publike që të përfillen nga qytetarët të gjitha masat e paralajmëruara nga Qeveria e Kosovës për arsye se, sipas tij, ruajtja e shëndetit është obligim edhe fetar, po aq sa ligjor, veçanërisht në rrethana kur

rrezikohemi nga sëmundje të panjohura. Ai ka thënë se Bashkësia Islame e Kosovës do të angazhohet për të kontribuar në ruajtjen e shëndetit publik dhe ka ofruar mbështetjen dhe gatishmërinë për t'i vënë kapacitetet e tyre në shërbim të vendit për tejkalimin e situatës.

Problemet që është duke i shkaktuar koronavirusi dhe masat



preventive ishin kryetëm edhe në takimin midis ministrit të Shëndetësisë, Arben Vitia dhe Ispeshkvit të Kishës Katolike në Kosovë, Imzot Dodë Gjergji.

Në këtë takim Imzot Dodë Gjergji shprehu gatishmërinë e Kishës Katolike për të kontribuar për tejkalimin e kësaj situatë si dhe e njoftoi ministrin Vitia për masat e ndërmarra deri më tani.

Njëkohësisht, ai u shpreh se janë duke e përcjellë me vëmendje çdo vendim qeveritar për tejkalimin e kësaj situatë. Gjithashtu, shprehu edhe gatishmërinë që të kontribuojnë për tejkalimin e gjendjes me të gjitha kapacitetet që kanë në dispozicion pasi, siç deklaroi ai, jeta e njeriut është primare dhe qëllimi i kishave është t'i shërbejnë jetës.

## Kurti takohet me Apostolovan, flasin për taksën dhe për vizitën në Bruksel

Prishtinë, 12 mars (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të enjten në takim përfaqësuesen speciale të BE-së në Kosovë,

Nataliya Apostolova. Një nga temat e takimit ishte vizita zyrtare e kryeministrit Kurti në Bruksel. Nga ana e saj, Apostolova përsëriti rezul-

tatin pozitiv të heqjes graduale të tarifës me Serbinë. Në lidhje me heqjen e plotë të tarifës, kryeministri Kurti argumentoi se heqja e plotë e

saj do të vijë si rrjedhojë e vendosjes së besimit në respektin e plotë e të ndërsjellët mes të dyja palëve.



## Bahtiri kërkon nga Rakiqi mos të pengojë punimet pranë lumit Ibër

MITROVICË, 13 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Jugut, Agim Bahtiri, ka kërkuar nga kryetari i Komunës të Mitrovicës së Veriut, Goran Rakiqi, që mos të pengojë kryerjen e punimeve në rregullimin e hapësirave pranë lumit Ibër, sepse ky është projekt i financuar nga Ministria e Mjedisit dhe i përkrahur nga Bashkimi Evropian. "Rakiqi nuk mund të kërcënojë me inspektorë dhe polici, sepse kjo është tokë e Kosovës dhe ai nuk mund të sillet si kryetar i një komune të Serbisë, pasi që është kryetar i një komune

të Republikës së Kosovës. Pra, ai duhet të heqë dorë nga pengimi i punëve sepse nuk e kemi ndërmend t'i ndalim punimet. Po ashtu, kërkoj nga Rakiqi që mos ta keqinformojë bashkësinë ndërkombëtare në lidhje me procesin e rregullimit të lumit Ibër, pasi unë jam në kontakt me gjithë faktorin relevant vendor e ndërkombëtar dhe nuk do të lejoj kurrfarë dezinformimi", ka thënë Bahtiri në reagimin e tij për media.

Ai ka theksuar se Ministria e Mjedisit duhet t'i dërgojë inspektorët e tyre në

mbikëqyrje të punimeve dhe lehtësim të punëve, pasi që toka ku po realizohet projekti është e tyre dhe financimi i projektit bëhet nga ta. "Njëkohësisht i kërkoj ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme që të ndërmarë veprime ligjore që policia të mos i pengojë punimet me urdhra politike që vijnë nga Beogradi. Po ashtu, kërkoj nga kryeministri i Qeverisë së Kosovës që t'i ndërmarë hapat e nevojshëm për ta mundur zhvillim normal të punimeve", ka thënë kryetari Bahtiri.



Vazhdon procesi i deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

## Nga gjithsej 4 694 zyrtarë, vetëm 676 prej tyre e kanë deklaruar pasurinë

Procesi i deklarimit vjetor të pasurisë, i nisur më 1 mars, do të përfundojë më 31 mars. Prej 4 694 zyrtarëve që kanë për obligim ligjor deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, kërkesës për deklarimin e pasurisë i janë përgjigjur 676 zyrtarë të cilët i kanë dorëzuar formularët e deklarimit të pasurisë në AKK



**EPOKA E RE**

**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 13 MARS - Procesi i deklarimit të pasurisë, i nisur më 1 mars 2020, ka vazhduar të realizohet në pajtim me Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave.

Procesi i deklarimit vjetor të pasurisë, i nisur më 1 mars, do të përfundojë më 31 mars. Prej 4 694 zyrtarëve që kanë për obligim ligjor deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, kërkesës për deklarimin e pasurisë i janë përgjigjur 676 zyrtarë të cilët i kanë dorëzuar formularët e deklarimit të

pasurisë në AKK.

Procesit të deklarimit vjetor të pasurisë janë të obliguar t'i nënshtrohen të gjithë zyrtarët e lartë publikë, me përjashtim të atyre që kanë deklaruar pasurinë me rastin e marrjes së detyrës pas datës 1 janar të këtij viti.

Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shaip Havolli, ka shprehur zotimin se gjatë procesit të deklarimit të pasurisë Agjencia Kundër Korrupsionit do të jetë në shërbim të të gjitha subjekteve deklaruese për t'i ofruar të gjitha informatat e nevojshme për zyrtarët publikë në mënyrë që procesi i deklarimit të pasurisë të përfundojë me sukses, gjithnjë duke respektuar obligimet e përcaktuara me ligj.

Zyrtarët publikë mund ta bëjnë deklarimin e pasurisë në AKK në mënyrë fizike dhe elektronike, ndërsa në funksionim të mbarëvajtjes sa më efikase të procesit të deklarimit të

pasurisë, Agjencia Kundër Korrupsionit ka në shërbim numrat e telefonit: +383 (0) 38-518-964; (0)38-200 10 728 ; dhe +383 (0) 38-518-912; (0)38-200 10 731.

Për informata të hollësishme rreth subjekteve deklaruese dhe listës së zyrtarëve të cilët janë të obliguar ta bëjnë deklarimin e pasurisë mund të vizitohet edhe uebfaqja zyrtare e AKK-së.

## Bashkëpunimi për të rinjtë e Kosovës, prioritet për MKRS-në, UNFPA-në e UNKT-në

PRISHTINË, 13 MARS (ER) - Ministrija e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka prituri të premtën në takim John Kennedy Mosoti, drejtor i UNFPA-së për Kosovë, Serbi dhe Maqedoni Veriore si dhe përfaqësues i UNFPA-së për Bosnjë e Hercegovinë. Në takim ishte e pranishme edhe shefja e UNKT-së në Kosovë Ulrika Richardson.

Ministria Dumoshi ka theksuar se është shumë e kënaqur me punën e mirë të agjencive të UN-it në Kosovë, e veçanërisht

UNFPA-së, punën e së cilës e çmon lart. Ndërkaq, Mosoti ka uruar ministren Dumoshi për marrjen e detyrës dhe e ka njoftuar me misionin dhe vizionin e UNFPA-së si dhe me projektet konkrete në Kosovë dhe me bashkëpunimin që ka pasur me institucionet e Kosovës për të shtyrë përpara çështje si edukata seksuale, aborti, struktura e popullsisë etj.

Në takim u diskutua për format e bashkëpunimit në çështje që kanë të bëjnë me angazhimin e të rinjve në projekte të

ndryshme, meqenëse komponentë e rëndësishme e MKRS-së është edhe rinia.

Ministria Dumoshi u shpreh se rinia është pjesa më vitale e Kosovës dhe aset i çmuar për të cilin duhet bërë akoma si në nivel institucional ashtu edhe në nivele të tjera. Ajo u shpreh e gatshme t'i ofrojë të gjitha kapacitetet dhe ndihmën e Ministrisë që bashkërisht me të gjitha organizatat që veprojnë në Kosovë ta fuqizojnë rininë përmes projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme.



## BQK-ja deklarohet për likuiditetin bankar

PRISHTINË, 13 MARS - Zëdhënësi i Bankës Qendrore të Kosovës, Kushtrim Ahmeti, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se BQK-ja është duke përcjell me vëmendje masat e ndërmarrja nga Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me koronavirusin dhe se konform këtyre masave BQK-ja ndërmerr veprimet e saj. "BQK-ja po përcjell me vëmendje masat e ndërmarrja

nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe konform këtyre masave BQK-ja ndërmerr veprimet e saj. Aktiviteti ekonomik në Kosovë është duke funksionuar në suaza normale dhe se masat e parapara nga Qeveria e Republikës së Kosovës sigurojnë kontinuitet të rregullt të aktivitetit ekonomik", ka thënë Ahmeti, duke shtuar se si rrjedhojë, BQK-ja nuk ndërmerr

ndonjë masë të re. Ai ka folur edhe për likuiditetin në vend, për të cilën gjë ka thënë se sektori bankar në Kosovë vazhdon të jetë ndër sektorët me likuiditetin më të lartë. "Sa i përket likuiditetit në vend, sektori bankar në Kosovë vazhdon të jetë ndër sektorët me likuiditetin më të lartë në rajon dhe më gjerë", ka deklaruar ai.

(A. MAVRAJ)



# BIE INTENSITETI I DENONCIMEVE PËR KEQPËRDORIM TË ÇMIMEVE

**EPOKA E RE**

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 MARS - Po vazhdon raportimi i qytetarëve të Kosovës në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) lidhur me shtrenjtimin e produkteve bazë si dhe atyre farmaceutike. Vetëm të premten deri në orën 14:30 ATK-ja ka pranuar 271 thirrje. Këtë e ka konfirmuar për gazetën "Epoka e re" zëdhënësjja e ATK-së, Valentina

Bytyqi-Sefa. Sipas saj, po vërehet se ka rënie të intensitetit të denoncimeve nga ana e qytetarëve. "Numri i thirrjeve të pranuar vetëm dje deri në orën 22:00 ka qenë 186, përmes së cilave është raportuar për rastet e bizneseve të cilat dyshohet se janë duke keqpërdorur situatën e krijuar nga koronavirusi për t'i rritur çmimet. Ndërsa vetëm sot deri në orën 14:30 kanë qenë 271 thirrje ku vërehet se ka rënie intensiteti i denoncimeve nga

ana e qytetarëve", ka thënë ajo. Sipas saj, raportimet kryesisht kanë qenë për rritje të çmimeve në produktet bazeike ushqimore dhe farmaceutike si: ushqimore: miell, sheqer, vaj dhe të ngjashme, si dhe në produktet farmaceutike si maska për mbrojtje, dezinfektues, alkool, strup, vitaminë C.

E lidhur me pyetjen se nga cilat regjione ka më së shumti thirrje, ajo ka thënë se akoma se nuk kanë të dhëna dhe se

shpejt do të dalin me raportin final. "Sa iu përket evidentimeve se nga çfarë qytete kemi pasur me shumë thirrje, ende nuk kemi arritur t'i nxjerrim, sepse jemi vetëm duke adresuar në regjionet përkatëse denoncimet për trajtim, mirëpo besoj se në raportin final do t'ju informojmë edhe për këtë kërkesë. ATK-ja do të veprojë konform verifikimeve dhe të gjeturave në terren, si dhe duke u bazuar në vendimin e

Ministrit të Financave dhe Transfereve. Vlen të theksohet se të gjitha veprimet tona janë në harmoni me Inspektoratin e Tregut, Prokurorinë dhe Policinë e Kosovës. ATK-ja shumë shpejt, pas finalizimit të raporteve nga terreni, do ta njoftojë opinionin publik për rezultatet. Ne u bëjmë thirrje që të raportojnë në dy linjat telefonike të cilat do të jenë të hapura çdo ditë nga ora 08:00 deri në 22:00", ka deklaruar Bytyqi Sefa.



## Punëtorët teknikë të sektorit privat kërcënojnë me ndërprerje të punës

Prishtinë, 13 mars (ER) - Sindikata e Pavarura e Sektorit Privat të Kosovës ka njoftuar të premten se kanë bërë vizitë në shumë Qendra të Mjekësisë Familjare në Prishtinë dhe në objektet e ministrive, ku punëtorët teknikë po bëjnë pastrimin e këtyre objekteve. Përmes një komunikate për media, kjo sindikatë thotë se pastrimet janë lënë në mëshirën e Zotit.

SPSPK-ja thotë se njerëzit e parë që mund të preken nga

koronavirusi janë kjo kategori e punëtorëve dhe zyrtarisht këta punëtorë nuk kanë pranuar asnjë maskë apo ndonjë pajisje mbrojtëse kundër kësaj sëmundje. "Kishte punëtorë që në mënyrë solidare nga stafi i qendrave të mjekësisë familjare iu ishin dhuruar punëtorëve aty e këtu ndonjë pajisje, derisa te punëtorët e pastrimit nëpër objektet e disa ministrive thonë se nuk bënë të jepjen pajisjet e kërkuara pasi që po krijohet panik, dmth. luhet me

shëndetin e punëtorëve për të mos hapur panik apo më mirë të themi rreziko shëndetin tënd, për të mos bërë panik të njerëzit e tjerë të shëndoshë. Nëse deri nesër datë 14.03.2020 në orën 8:00 nuk pajisen këta punëtorë me pajisje adekuate ne do t'i thërrasim kryetarët e shoqatave dhe do të vendosim për ta ndërprerë punën. Qeveria për këto gjëra ka ndarë 10 milionë euro, ne të kujt jemi, pyesin punëtorët", thuhet në reagimin e SPSPK-së.



# KËRKOHEM SHTYRJE E AFATEVE BIZNESORE NGA BANKAT DHE ZRRE-ja

Oda Ekonomike Amerikane ka kërkuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë ta shtyjë liberalizimin e tregut të energjisë deri në krijimin e rrethanave të duhura për zbatim. Po ashtu, edhe kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Berjani, ka kërkuar të shtyhen të gjitha pagesat nga bizneset pa interes dhe pa penallti për një afat tremujor për bankat e Kosovës dhe në të gjitha institucionet e tjera të qeverisë që nuk prekin vitalitetin e funksionimit të shtetit



300,000-700,000 euro, ndërsa ata konsumatorë që nuk arrijnë të nënshkruajnë marrëveshje me furnizuesin mund të përballen me shtrenjtim të çmimit të energjisë deri në 200 për qind. Kjo, pa dyshim, është në kundërshtim me përfitimet e liberalizimit të tregut të energjisë", thuhet në komunikatën e dërguar medieve. Më tej theksohet se nëse Zyra e Rregullatorit të Energjisë dështon ta përmbushë njërin prej qëllimeve thelbësore në misionin e saj e që është mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve të energjisë elektrike, odat ekonomike i bëjnë thirrje komisionit përkatës parlamentar që mbikëqyr ZRRE-në, por edhe deputetëve të Republikës së Kosovës që të kërkojnë nga ky institucion rregullativ që të përmbahet nga vendimet që cenojnë përparësitë konkurruese të ndërmarrjeve prodhuese, vështirojnë operimin e sektorit privat dhe investitorëve të huaj në Republikën e Kosovës.

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 13 MARS - Oda Ekonomike Amerikane ka kërkuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë ta shtyjë liberalizimin e tregut të energjisë deri në krijimin e rrethanave të duhura për zbatim. Po ashtu, edhe kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Berjani, i ka dërguar një letër kryeministrit Albin Kurti me anë të së cilës ka kërkuar që si masë parandaluese për koronavirusin të shtyhen të gjitha pagesat nga bizneset pa interes dhe pa penallti për një afat tremujor për bankat e Kosovës dhe në të gjitha institucionet e tjera të qeverisë që nuk prekin vitalitetin e funksionimit të shtetit.

Oda Ekonomike Amerikane ka kërkuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë ta shtyjë liberalizimin e tregut të energjisë deri në krijimin e rrethanave të duhura për zbatim.

Përmes një komunikate për media, Oda Ekonomike Amerikane, Oda Ekonomike e Kosovës dhe Këshilli i Investitorëve Evropian theksojnë se përgjatë periudhës së kaluar dymbëdhjetëmujore nuk ka ndryshuar asnjë rrethanë e cila do ta lejonte zbatimin e duhur të akteve ligjore të cilat parashohin liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, respektivisht furnizimin e konsumatorëve të sipërcekur komercialë me energji

elektrike me tarifa jo të rregulluara. "Pavarësisht se në Kosovë janë licencuar disa operatorë për furnizim me energji elektrike, duhet nënvizuar se vetëm njëri prej tyre ka kapacitetet që të funksionojë në praktikë si furnizues i mundësisë së fundit. Në rrethana të tilla të ofertës së kufizuar dhe detyrimit për të kaluar në treg të liberalizuar, konsumatorët komercialë do të ballafaqohen me situatë kur fuqia e tyre negociuese si konsumatorë është më e kufizuar, duke bërë që ata të paguajnë tarifa të energjisë elektrike, më të larta se mesatarja e tarifave të rregulluara. Në këto rrethana ekziston, po ashtu, mundësi reale që operatori në fjalë të abuzojë me pozitën dominuese, duke cenuar kështu edhe parimet e ekonomisë së tregut me konkurrencë të lirë, që është bazë e rregullimit

ekonomik të Republikës së Kosovës", thuhet në njoftimin e OEAQ-ut.

Sipas njoftimit, një situatë e tillë do të rëndonte mbi një numër konsumatorësh komercialë të sektorit prodhimit dhe rrjedhimisht do të ishte në kundërshtim me përpjekjet për fuqizimin e industrisë prodhuese të Kosovës dhe përmirësimin e bilancit tregtar, në një kohë kur ndërmarrjet prodhuese ballafaqohen me presion të shtuar konkurrues nga tregjet ndërkombëtare, si dhe me vështirësi të tjera ligjore e rregullative, që pamundësojnë fuqizimin e tyre. Sipas OEAQ-ut, zbatimi i këtij vendimi do ta përkeqësonte edhe ofertën e Kosovës për investitorët e jashtëm. "Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe Këshilli i Investitorëve Evropianë

përsërisin shqetësimin e tyre se nga negociatat preliminare me furnitorin aktual vitin e kaluar ishte paralajmëruar mundësia e rritjes për 30-70 për qind të çmimit të furnizimit me energji elektrike, gjë që i bie që një ndërmarrje e cila ka faturë vjetore në shumë prej 1 milion eurosh, në kushte të ofertës së kufizuar dhe detyrimit për të kaluar në treg të liberalizuar, do të duhej të paguante një shumë shtesë prej

## Shoqata e Naftëtarëve kërkon nga qeveria që t'ò shtyjë pagesat e bizneseve për bankat për tre muaj

Kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Berjani, i ka dërguar një letër kryeministrit Albin Kurti me anë të së cilës ka kërkuar që si masë parandaluese për koronavirusin të shtyhen të gjitha pagesat nga bizneset pa interes dhe pa penallti për një afat tremujor për bankat e Kosovës dhe në të gjitha institucionet e tjera të qeverisë që nuk prekin vitalitetin e funksionimit të shtetit. "Duke parë zhvillimet e fundit në region dhe botë që janë duke vepruar në marrjen e masave preventive, bizneset e Kosovës po angazhohen në përkrahje të situatës dhe

rekomandimeve të Qeverisë së Kosovës, andaj kërkojmë nga ju, z. kryeministër, që të veproni në kohën kur është e arsyeshme që t'i merrni këto masa: 1. Të shtyhen të gjitha pagesat nga bizneset pa interes dhe pa penallti për një afat tremujor, për bankat e Kosovës dhe në të gjitha institucionet e tjera të qeverisë që nuk prekin vitalitetin e funksionimit të shtetit. Vlen t'i falënderoj të gjitha bizneset që furnizojnë me produkte të konsumit të gjerë për mosrritje të çmimit dhe bizneset e naftës që në këtë moment po bëjnë edhe uljen e çmimeve", thuhet në letrën e Berjanit.



## Ministri Mustafa merr përkrahjen e UNDP-së për projektet bujqësore

PRISHTINË, 13 MARS (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do ta vazhdojë bashkëpunimin me UNDP-në, me qëllim të realizimit të projekteve në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, që për qëllim kanë avancimin e këtyre sektorëve dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Kështu është thënë gjatë takimit që Ministri i MBPZHR-së, Besian Mustafa, zhvilloi sot

me përfaqësuesen e përhershme të UNDP-së, Maria Suokko, me të cilin kanë diskutuar edhe për bashkëpunimin e deritanishëm mes dy institucioneve.

Po ashtu, ministri ka falënderuar UNDP-në për mbështetjen e vazhdueshme për sektorin e bujqësisë në Kosovë dhe me këtë rast e ka njoftuar atë me investimet dhe prioritetet e ministrisë në kuadër të Programit për Bujqësi

dhe Zhvillim Rural të këtij viti. Në anën tjetër, përfaqësuesja e përhershme UNDP-së, Maria Suokko, theksoi se si institucion do ta vazhdojnë përkrahjen e këtij sektori përmes projekteve të ndryshme për fermerë përmes angazhimit të ekspertëve në fusha të ndryshme të zhvillimit bujqësor si dhe projekteve për zhvillimin e zonave rurale, me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe rritjes së punësimit në vend.



## Në Mitrovicë shënohet 21-vjetori i masakrës në treg

MITROVICË, 13 MARS (ER) - Nën kryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, drejtorë të drejtorive komunale, familjarë të martirëve dhe qytetarë që atë ditë kishin marrë plagë të ndryshme, janë mbledhur pranë obeliskut i cili është vendosur në vendin ku kishte ndodhur ngjarja e 21 vjetëve më parë, për t'i nderuar viktimat dhe për të kujtuar këtë ditë. Me këtë rast, nënkryetari Mujka ka përkujtuar 13 marsin e vitit 1999, të cilën e ka cilë-

suar një ditë të tmerrshme, ku kishin humbur jetën dhe ishin lënduar qytetarë të pafajshëm të qytetit të Mitrovicës. "Jemi mbledhur sot këtu, pranë këtij obelisku, për t'i përkujtuar viktimat e masakrës së tregut e cila ka ndodhur më 13 mars të vitit 1999, ku humbën jetën 6 bashkëqytetarë tanë dhe janë plagosur 128 të tjerë. Në këto çaste ndihemi të pikëlluar për humbjen e tyre, në të njëjtën kohë ne duhet të ndihemi krenarë, sepse falë gjakut të tyre

ne sot e gëzojmë lirinë, duke e ndërtuar shtetin dhe institucionet, andaj ne përulemi dhe jemi falënderues përherë për sakrificën e tyre", ka thënë Mujka. Në vendin e ngjarjes, ku 21 vjet më parë kishte ndodhur atentati, të mbijetuarit, të cilët kishin pësuar lëndime të rënda, duke u dëmtuar këmbët, duart e pjesët e tjera të trupit, kërkuan nga institucionet e shtetit që të bëjnë më shumë për ta, pasi që jeta e tyre është mjaft e rëndë.



## Komuna e Skenderajt koordinon veprimet për parandalimin e koronavirusit



SKENDERAJ, 13 MARS (ER) - Kreu i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, të premten ka thirrur mbledhjen e jashtëzakonshme të Shtabit Emergjent lidhur me parandalimin e infeksionit COVID-19. Gjatë kësaj mbledhje kryetari Jashari së bashku me anëtarët e Shtabit u koordinuan për zbatimin e masave parandaluese që ka vendosur Komuna e Skenderajt gjatë ditës së djeshme. Drejtoria për Shëndetësi ka dërguar ekipin mjekësor me të gjitha pajisjet dhe mjetet e nevojshme në pikën kufitare në Jarinjë, por në anën tjetër ka edhe një ekip mobil, rezervë për rastet e rrezikut.

Stacioni Policor në Skenderaj ka ofruar gatishmërinë e tij që të intervenojë sipas kërkesave të komunës.

Inspektorati Komunal ka filluar inspektimet në qendrat tregtare, barnatore e biznese dhe për çdo rast të ngritjes artificiale të çmimeve do të aplikohet gjobë sipas legjislacionit në fuqi.

I pari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, apelon qytetarët që kur hasin në ngritje artificiale të çmimeve ta kenë faturën e blerjes si dëshmi dhe të kontaktojnë në linjat e ATK-së 080080800 ose tek Inspektorati Komunal: 028/582-090 045/189-300 044/373-945.

## Inspektorët e Malishevës në aksion për zbatimin e urdhërësës për mbylljen e lokaleve në orën 23:00

MALISHEVË, 13 mars (ER) - Njëra nga masat parandaluese për mbrojtje nga koronavirusi (COVID-19), është edhe mbyllja e lokaleve hoteliere në orën 23:00, dhe me qëllim të zbatimit të kësaj mase, inspektorët komunal të Malishevës, në bashkëpunim edhe me Policinë e Kosovës, gjatë natës së mbrëmshme, i kanë vizituar të gjitha lokalitetet hoteliere dhe i kanë njoftuar pronarët lidhur me masën, si dhe i kanë urdhëruar t'i mbyllin lokalitetet, edhe pse shumica prej tyre ishin

të njoftuar dhe e kanë zbatuar këtë masë.

Drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit, Dibran Kastrati, së bashku me inspektorët dhe zyrtarët policorë, i kanë inspektuar të gjitha lokalitetet hoteliere në qytetin e Malishevës dhe në disa vendbanime të tjera dhe në të gjitha rastet i kanë informuar pronarët për masën parandaluese që duhet ta zbatojnë.

Drejtori Kastrati ka bërë me dije se "inspektorati komunal do të jenë në shërbim 24 orë në ditë

dhe pas paralajmërimeve të shpërndara, të gjithë ata që nuk i zbatojnë masat për mbrojtjen e shëndetit publik, do të gjobiten sipas ligjeve në fuqi".

Përndryshe, inspektorati komunal i Malishevës është urdhëruar nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, për zbatimin në përpikëri të të gjitha masave parandaluese për mbrojtje nga COVID-19, të cilat i ka ndërmarrë qeveria dhe organet përgjegjëse shëndetësore në vend dhe, sipas masave të parapara nga



Organizata Botërore e Shëndetësisë, për të mbrojtur nga ky virus, i cili është shpallur pandemi.

## Gjilani mbyll tregun e kafshëve dhe dezinfekton disa hapësira publike

GJILAN, 13 MARS (ER) - Komisioni emergjent i Gjilanit ka njoftuar se është bërë dezinfektimi i objekteve të ndryshme si administratës komunale, bibliotekës, objektit të Stacionit të Autobusëve dhe të Qendrës së Mjekësisë Familjare në lagjen "Dardania". Drejtori i Shëndetësisë, Selami Xhemaili, ka publikuar vendimet që sot ka marrë komisioni, ku do të dezinfektohet objekti i stadiumit, stacioni policor dhe palestra e sporteve,



ndërkaq në ditët në vijim është planifikuar edhe dezinfektimi i

të gjitha qendrave të mjekësisë familjare, për të vazhduar edhe

me të gjitha objektet publike. Po ashtu, ai ka konfirmuar se është marrë vendim, në koordinim edhe me kryetarin e komunës, Lutfi Haziri, për mbylljen e tregut të kafshëve në një afat të pacaktuar, pastaj vendimi tjetër për largimin e të gjithë shitësve të pemëve dhe perimeve nga hapësira publike, vendim për ndalimin e shitjes dhe ushqimeve në hapësirat publike, vendimi për lirim të njërës nga puna, në rast se janë të punësuar të

dy, do të lirohen nga puna shërbësit civilë të cilët janë me sëmundje kronike. "Komisioni ka apeluar te të gjithë qytetarët e Komunës së Gjilanit që të mos krijojnë situatë të panikut, siç janë rastet e furnizimit me produkte ushqimore, e konkretisht ata që mundohen të krijojnë rezerva të miellit, derisa ka potencuar se nuk ka hapësirë për shqetësim në atë masë sa të krijojnë rezerva të mëdha ushqimore", ka thënë Xhemaili.

# Idenë e bashkimit kombëtar nuk mund ta dekonstruktojë askush



**Shkruan: Jakup KRASNIQI**

Idenë e bashkimit të shqiptarëve janë përpjekur ta dekonstruktojnë që nga vitet e tridhjeta të shekullit XIX e deri më sot. Ka pasur e, si po duket, ka edhe sot përpjekje për ta mohuar jetën e përbashkët të shqiptarëve gjatë historisë, bile edhe para vitit 1913, gjë që nuk është aspak e vërtetë, pasi ideja e bashkimit kombëtar nuk mund të dekonstruktohet nga askush as nga brenda e as nga jashtë. Bashkimi i kombit shqiptar si ide e aspiratë nuk ka pushuar asnjëherë edhe pse i ka pasur ngritjet e rëniet e saj. Në vazhdim, në pika të shkurtra do ta tregojmë kohën kur lindi ideja e bashkimit kombëtar të shqiptarëve.

**I** Përpjekjet e shqiptarëve për konsolidimin e kombit duhet t'i kërkojmë në vitet e fundit të shekullit XVIII dhe në dekadat e para të shekullit XIX. Idetë e iluminizmit e të shkencës të përhapura në qytetin e Voskopojës në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, mund të konsiderohen si pararendëse të gjuhës shqipe e të kombit tonë ose thënë ndryshe një Rilindje e hershme e kombit shqiptar. Këto ide nuk u patën pritur mirë nga Perandoria Osmane e cila për t'i penguar ato, në mars të vitit 1830, organizon në qytetin e Manastirit një manifestim gjeja për t'i prezantuar të arriturat në modernizimin e ushtrisë osmane sipas sistemit të atëhershëm evropian. Kështu ajo e organizoi Masakrën e Manastirit më 9 gusht 1930, e para kësaj kishte organizuar edhe masakra të tjera në Shqipërinë e Jugut të orientuara kundër Elitës intelektuale shqiptare. Kjo ishte bërë sipas kërkesës së Sulltanit, i cili kërkonte që: "Shqipëria duhet mposhtur me çdo kusht, me hekur, zjarr e barot". Në anën tjetër Porta e Lartë kishte kohë që të krishterëve të Ballkanit ua kishte lejuar hapjen e shkollave në gjuhë e tyre amtare edhe në territorin shqiptar, por një gjë të

tillë nuk dëshironte t'ua lejonte shqiptarëve. Qëllimi i Perandorisë Osmane ishte që shqiptarët të mbeteshin pa shkolla e pa elitat e tyre prijatë kombëtare. Ndoshta këtë e bënte pse një pjesë e madhe e tyre i kishte islamizuar dhe dëshironte që t'i ruante në shërbim të saj. Përveç Perandorisë Osmane përndjekje asimiluese e eliminuese ndaj shqiptarëve i kishte filluar edhe politika Greke që përfaqësohej nga "Megali Idea" (1844). Ideatori i kësaj "Ideje të madhe" ishte Kryeministri i Greqisë, J. Koleti i cili dhe zyrtarisht shpalli, politikën ekspansioniste të Greqisë ndaj shqiptarëve. Kjo e fundit përveç përndjekjes së shqiptarëve, ajo nuk hezitonte që të helmonte çdo atdhetar shqiptar që punonte për Shqipërinë e shqiptarët, kështu në shënjestër të tyre qe edhe autori i Evëtarit të parë shqip Naum Veqilhargjin (1854). Naum Veqilharxhi, në vitin 1846 shkruante: "Ka ardhur koha që t'i flakim të gjitha paragjykimet e vjetruara, ka ardhur koha që të mendohe mi me pjekuri dhe më me guxim të këmbëjmë udhë, duke marrë këtej e tutje si shembull kombet e përparuara

mbi tokë... Le të ecim pa u lëkundur, me guxim, me durim dhe me këmbëngulje". Kjo vetëdije e lartë kombëtare e pati shtyrë atë që të ishte shqiptari i parë i shkruar me kombësi shqiptare në Rumani. Po atë vit përpjekjeve greke, në mënyrë edhe më të egër i shtohet edhe Serbia e Garashaninit me Projektin (Naçertanjes) për shpërnguljen e shqiptarëve nga trojet e veta (1844). Këto shtete, Greqia e Serbia, zhvilluan politika ekspansioniste ndaj tokave shqiptare, pasi ato nuk donin që ta pranonin prezencën e shqiptarëve e as të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Pak vite më vonë këtyre përpjekjeve për të grabitur tokat e banuara me shqiptarë u bashkohet edhe Mali i Zi. Këtij të fundit, Kongresi i Berlinit i dha toka të banuara denbabaden me shqiptarë. Jo vetëm këtë herë, Fuqitë e Mëdha të Evropës u treguan shumë "bujare" për t'u dhuruar krishterëve të Ballkanit troje shqiptare. E ata pastaj jo pak herë ushtruan politika të gjenocidit mbi shqiptarët. Nga kjo del se në politikën e gjenocidit që i ushtruan këto vende, hisen e tyre e kishin edhe Fuqitë e Mëdha të kohës.

Me gjithë përpjekjet e shumta të armiqve të shqiptarëve, ideja e kombit shqiptar kishte marrë udhë, të cilën rrugë armiqët e egër, të pabesë e të shumtë të shqiptarëve nuk mund ta ndalnin, por nuk mund të themi se nuk e dëmtuan substancën biologjike të kombin tonë e sidomos hapësirën e trojeve shqiptare në Gadishullin Ilirik. Kjo e fundit 9Serbia), ndjekjen e parë të madhe të shqiptarëve nga trojet e tyre e bëri në vitet 1876/78, kur u shpërngulën nga Shqipëria e Toplicës rreth 600 fshatra shqiptare. Me këto politika që kishin qëllim shfarosjen e tërësishme ose të pjesërishtme të shqiptarëve, sidomos ata të Shqipërisë së Epërme e cila asokohe përfshinte Shqipërinë e sotme të veriut, Kosovën e Iliridën (Maqedoninë Perëndimore) dhe Shqipërinë e Toplicës, Kosova Lindore si dhe trojet shqiptare në Mal të Zi. E njëjta politikë ndaj shqiptarëve u ndoq edhe nga qeveritë greke deri në vitin 1949 ndaj shqiptarëve në përgjithësi e të atyre të Çamërisë në veçanti. Këto ishin tri shtete armiqësore (Turqia, Serbia, Greqia) të cilave

më vonë iu shtua edhe Mali i Zi që nuk e dëshironin formimin e kombit shqiptar, gjuhën dhe arsimin e tyre si dhe çlirimin dhe bashkimin e shqiptarëve. Idetë antishqiptare e shoviniste të këtyre vendeve ballkanike jo pak herë, deri dhe në kohën tonë kanë përfunduar në politika krimi e gjenocidi, nga të cilat politika nuk janë distancuar as sot e kësaj dite. Ta saktësojmë, në këto politika të gjenocidit janë dalluar, Serbia dhe Greqia. Për të cilat politika nuk janë dënuar asnjëherë nga vendet e Demokracisë Perëndimore.

## Përfundim

Në fund të shekullit XX shqiptarët e Kosovës nuk mundën ta realizojnë idenë e bashkimit me Shqipërinë, por arritën të çlirohen nga Serbia dhe ta shpallin pavarësinë dhe sovranitetin e shtetit. Por, me këtë nuk dekonstruktohet ideja e bashkimit. Kjo ide mund t'i ketë rëniet e saj, por pa asnjë dyshim që do t'i ketë edhe ngritjet e saj deri në realizim. Ashtu si nuk kanë mundur ta pengojnë çlirimin e Kosovës, nuk do të mund ta pengojnë as idenë e bashkimit të kombit.



## Trumpi pritet që të deklarojë gjendjen e emergjencës kombëtare

WASHINGTON, 13 MARS - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, do të shpallë gjendjen e emergjencës kombëtare për shkak të koronavirusit. Në ShBA numri i të prekurve rritet nga dita në ditë, e kjo ka sjellë mjaft shqetësim në popullatë. Në mediet braziliene u publikua lajmi se presidenti i

vendit, Jair Bolsonaro, rezultoi pozitiv me koronavirus (lajmin e dha i biri), ndërsa vetë ky i fundit tha se pas një testi të dytë, rezultoi se nuk është i infektuar. Trumpi dhe Bolsonaro u takuan disa ditë më parë, shtrënguan duart e hëngrën drekë. Pritet që Trumpi të mbajë një konferencë me gazetarë, në

mes të konfuzionit dhe kaosit të shkaktuar. Ndërkohë që "Shtëpia e Bardhë" ka sqaruar se familja e Trumpit nuk do të izohet. Pritet që të hënën të mbahet një video-konferencë mes liderëve të G7-ës, ku edhe do të diskutohet plani i masave për të luftuar pandeminë.



# A po bëhet Putini president i përjetshëm?

Për javë të tëra, ligjvënësit diskutuan amendamentet e kushtetutës, të cilat presidenti Vladimir Putin tha se duhet t'i japin më shumë fuqi parlamentit, por befasia ndodhi kur anëtarët e Dumës në vend që të dalin me një ide më të mirë, propozuan rritjen e fuqisë së Putinit

MOSKË, 13 MARS - Spekulumet rreth të ardhmes politike të presidentit rus Vladimir Putin, u qartësuan këtë javë. Udhëheqësi rus shfrytëzoi autoritetin e tij për të ndryshuar kushtetutën e tanishme ruse duke hequr kufirin e mandateve presidenciale. Kjo lëvizje i mundëson atij të qëndrojë në pushtet pas mbarimit të mandatit aktual në vitin 2024. Për javë të tëra, ligjvënësit diskutuan amendamentet e kushtetutës, të cilat presidenti Vladimir Putin tha se duhet t'i japin më shumë fuqi parlamentit. Por befasia ndodhi kur anëtarët e Dumës në vend që të dalin me një ide më të mirë, propozuan rritjen e fuqisë së Putinit, ka njoftuar voa. "Rekomandoj që të heqim kufirin e mandateve presidenciale, ose të shtojmë një nen në kushtetutë që thotë se kur ndryshimet kushtetuese hyjnë në fuqi presidenti në detyrë ka të drejtë të zgjidhet president si çdo qytetar tjetër", tha Valentina Tereshkova,

ligjvënëse ruse. Nisma ishte e koordinuar mirë me Kremlinin. Presidenti Putin shfaqti mbështetje të menjëhershme. "Në parim, ky opsion është një mundësi, por me një kusht. Nëse gjykata kushtetuese jep vlerësim zyrtar se ky amendament nuk bie ndesh me parimet dhe dispozitat kryesore të kushtetutës", tha Putini. Ky ndryshim i jep mundësi atij që të mbajë postin e presidentit për dy mandate tjera, deri në vitin 2036, gjë që e bën atë udhëheqësin më jetëgjatë në historinë ruse. Kritikët e cilësuan lëvizjen si grabitje të pushtetit. "Nuk pati debat të duhur, as diskutime politike. Ishte si një grusht shteti, por askush nuk e pa ashtu, sepse njerëzit thonë nëse autoritetet më të larta e duan këtë, çfarë mund të bëjmë ne", thotë analisti Boris Kagarlitsky. Disa protestues në Moskë e cilësuan këtë një përpjekje të Putinit për t'u bërë president i përjetshëm.



Sidoqoftë tubimet e mëdha të opozitës janë penguar, pas rregullit të ri që ndalon grumbullimet me arsye shqetësimet për koronavirusin. Analistët thonë se prapa lëvizjeve të Putinit qëndron elita e Rusisë që nuk është e gatshme të ndahet nga epoka e tij, por edhe nga përfitimet që

erdhën me të. "Shumë njerëz mendojnë se Putini dëshiron të mbajë pushtetin përgjithmonë. Ndoshta dëshiron, por nuk do ta bëjë për arsye shëndetësore. Nuk ka të bëjë me Putinin. Ka të bëjë me procesin e ndryshimeve, gjë që ata s'mund ta bëjnë në rrugë të ligjore",

thotë Boris Kagarlitsky, analist politik. Propozimi i ri u miratua njëzëri në parlament dhe tani pritet nënshkrimi i Putinit. Kjo, përpara zgjedhjeve kombëtare muajin e ardhshëm të cilat pritet t'i fitojë sërish Putini, njeriu që udhëheq Rusinë prej 20 vjetësh.

## Londra mbështet mbajtjen e samitit të vendeve anëtare të KS të OKB-së

LONDËR, 13 MARS - Britania e Madhe tha të premten se e mbështet idenë e presidentit rus, Vladimir Putin, për të mbajtur një samit midis krerëve të shteteve që janë anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për t'i diskutuar masat ndërkombëtare të paqes dhe sigurisë. Britania është vendi i fundit që dha pëlqimin e vet, pasi Putini, në muajin janar propozoi që të takohen udhëheqësit e Rusisë,

Kinës, Shteteve të Bashkuara, Francës dhe Britanisë. Franca dhe Kina kanë shprehur tashmë pajtimin e tyre për samitin, ndërsa një zyrtar i lartë i administratës amerikane tha në muajin shkurt se presidenti, Donald Trump, ishte i gatshëm të takohej dhe të diskutonte për kontrollin e armëve. Zëdhënësi i Kremlin, Dmitry Peskov tha se Britania e Madhe kishte shprehur interes për idenë e Putinit dhe se vendi më i mirë për takimin mund të ishte

sesioni i 75-të i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, i planifikuar të mbahet më 15-30 shtator në Nju Jork. Ambasada britanike në Moskë, konfirmoi mbështetjen e Britanisë për mbajtjen e takimit. "Britania në tërësi mbështet idenë e një takimi midis krerëve të shteteve të anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit, me qëllim të diskutimit të çështjeve të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare", tha ambasada britanike.





# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



*Shijo  
Pranverën  
me...*



E rrallë

## Qindra majmunë të uritur terrorizojnë qytetin tajlandez teksa koronavirusi largon turistët



Qindra majmunë të egër në Tailandë kanë dalë në qytete dhe janë filmuar duke luftuar për një banane të vetme teksa epidemia e koronavirusit ka larguar turistët e shumtë

që normalisht u jepnin atyre ushqim. Pamjet e frikshëm nga qyteti i Lopburi tregojnë kafshët e egra që përplasen e sulmojnë njëra-tjetrën.

FOTO E DITES



Ushtarët e Shqipërisë solidarizohen dhe japin kurajë nga Afganistani pas përhapjes së koronavirusit.

E jashtëzakonshme

## Italiani vesh rrethin gjigant të kartonit për ta nxitur mbajtjen e distancës shoqërore

Një burrë italian ka marrë masa ekstreme për t'i nxitur bashkatdhetarët t'i zbatojnë rregullat e distancës sociale në luftën ndaj koronavirusit të ri pas klasifikimit si pandemi nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Në pamjet e shpërndara në rrjetet sociale ai ecën në rrugët e Romës duke veshur në brez një disk gjigant për ta sensibilizuar distancimin social. Në Itali ka pasur 827 vdekje nga 12 462 raste të konfirmuara të COVID-19.



### BARSOLETA E DITËS



Vjen gruaja e nervozuar në shtëpi.  
- Zemër, do ta padis taksistin në gjykatë.  
Sot, në dy raste, për pak sa nuk më vrau.  
- Mos u ngut zemër. T'i japim edhe një rast.




### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min


**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



#### Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min  
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.  
**Regjia:** Jake Kasdan



#### Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min  
**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj.  
**Regjia:** J.J. Abrams



#### Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE


Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: Kino ABC.

 <p><b>DASHI</b> Për të lindurit e kësaj shenje është dita e duhur për të nisur 'e-mail'-et e lëna pas dore.</p> <p><b>DEMI</b></p>	 <p>Mund t'ju komunikojnë diçka gabim por, fatmirësisht, do të rezultojë në favorin tuaj.</p> <p><b>BINJAKËT</b> Ekziston mundësia që të</p>	 <p>përballemi me një dramë gjatë javës që vjen.</p> <p><b>GAFORRJA</b> Ekziston mundësia të keqkuptoheni teksa</p>	 <p>rrëfeni diçka me shumë sinqeritet. Kjo nuk do të thotë që të shqetësoheni, duke e vështirësuar edhe më tej situatën.</p>	 <p><b>LUANI</b> Keni kaluar ditë të lodhshme kohët e fundit në punë, por sot do të ndiheni shumë më mirë.</p> <p><b>VIRGJËRESHA</b></p>	 <p>Mund të ndiheni të shqetësuar për shkak të marrëdhënies suaj me një prej kolegëve.</p> <p><b>PESHORJA</b></p>
 <p>Mund të kaloni një ditë të qetë në punë, por nuk përjashtohet mundësia që të tensionoheni në situata të caktuara</p>	 <p><b>AKREPI</b> Sot mund të mos keni dëshirë të komunikoni shpesh. Qëndroni të qetë dhe veproni ashtu sikurse dëshironi.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Përgjithësisht do të jetë një ditë e mirë, por mund ta ndieni mungesën e emocioneve, pasi asgjë e re nuk po ndodh.</p>	 <p><b>BRIC-JAPI</b> Lidhjet tuaja me disa kolegë në punë mund të shkojnë edhe më tej. Kjo mund të jetë diçka pozitive. Proveni.</p>	 <p><b>UJORI</b> Një lajm të cilin kishit kohë që e prisnit, më në fund do të vijë te ju.</p> <p><b>PESHQIT</b> Do të jetë një ditë e</p>	 <p>ngarkuar dhe mund të jeni paksa mbrapa me planet tuaja.</p>

## E lyer me ar, Rita Ora vazhdon ta paralajmërojë klipin e këngës “How to be lonely”



**T**ë premten në orët e hershme të mëngjesit artistja shqiptare me famë botërore, Rita Ora, publikoi këngën e saj më të re. “How to be lonely” mban titullin kënga e saj e re, e cila momentalisht është

publikuar vetëm në versionin audio dhe brenda pak ditësh do të vijë edhe me klip. Rita ka kryer xhirimet e klipit javën e kaluar dhe do të shfaqet në disa skena mjaft provokuese, duke i lënë pak vend imagjinatës.

## Ben Affleck dhe Ana de Armas nuk mund ta fshehin më dashurinë e tyre



**A**ta u vunë re së bashku gjatë një udhëtimi për në Kubë javën e kaluar. Dhe këtë fundjavë të kaluar, Ben Affleck dhe Ana de Armas, u larguan për në Kosta Rika ku po shijojnë pushimet së

bashku. Të dy nuk mund të kishin shikuar më nga afër pasi shijuan një shëtitje zbathur në rërë këtë javë me aktoren e ‘Bond’, e cila u shfaq e mbështetur në yllin e Hollywoodit ndërsa ia vendosi krahun rreth belit.



## Jennifer Lopezi, e panxirë

**T**animë e kemi kuptuar të gjithë se të famshmit që duken jashtëzakonisht mirë gjatë gjithë kohës kanë pasur një ekip të tërë grimierësh, estetistësh, parukierësh, trajnerësh e dietologësh. Këta profesionistë sigurisht përdorin

produktet dhe shërbimet më të mira në botë dhe rezultati është në këtë rast, Jennifer Lopez, perfekte në çdo kënd, ndriçim a rrethanë. Paparacët fotografuan këngëtarën dhe aktoren rrugëve të Miamit pa zgjatime flokësh, pa grim dhe e pa nxirë.

## Kehlani publikon “Toxic”



**K**ehlani u rikthye me këngën e saj të re të quajtur “Toxic”, duke numëruar si projekt të dytë për këtë vit pas “Valentine’s Day (Shameful)”. Kënga fokusohet rreth elementeve toksike të një lidhjeje

romantike dhe është shkruar nga G.Ry dhe KBeaZy. “E gjithë kjo dashuri është toksike, gjithë këto puthje dhe përqafime janë gjë /Ti je një drogë e mallkuar, je toksik”, këndon ajo.



# C.S. LEWIS: SHIJE TË NDRYSHME NË LETËRSI

Jam menduar gjatë për problemin shqetësues të pikpamjeve të ndryshme për atë që quhet “shije” në letërsi, ndonëse kuptimet e fjalës “shije”, nëse shqyrtohen seriozisht, shmangin çdo lloj problemi. Nëse mendojmë se të zgjedhësh midis shkrimtares britanike të romancave, Ruby M. Ayres-it dhe Tolstoit është si të zgjedhësh midis birrës së butë dhe të fortë, atëherë kot të diskutosh, ose diskutimi s’do të ishte serioz. Por, nuk mendoj kështu. Këtë mund ta themi, në kulmin e një debati, por s’është argument i besueshëm as për atë që e thotë. Ideja që disa parapëlqime në art janë vërtetë më të mira se të tjerat s’mund të shmanget dhe meqenëse s’kemi një test objektiv për ta pëcaktuar, problemi vetvetiu krijohet.

Pa menduar se problemi zgjidhet në një shkrim, e kam pyetur veten seriozisht, nëse s’jemi ne që e bëjmë të vështirë problemin, madje në mënyrë të panevojshme ngaqë që në fillim bëjmë një pohim të gabuar. Duhet thënë dhe rithënë se shkrimtari hamendëson se disa njerëz e pëlqejnë artin e dobët në po të njëjtën mënyrë si të tjerët pëlqejnë artin e mirë. Këtë e vë në dyshim. Unë parashatroj argumentin se arti i dobët, në një

kuptim, s’ka asnjëherë sukses me asnjë lexues.

Së pari duhet të shpjegoj se çfarë është për mua arti i dobët. Nëse me artin e dobët ju nënkuptoni, le të themi, këngët epike të Nibelungëve, poemën epike të Walter Scott-it, “Marmionët”, atëherë s’diskutohet që teoria që të do shtjelloj këtu nuk funksionon. Duhet ta ulni standartin për art të dobët shumë më shumë se kaq. Me art të dobët ndoshta nënkuptoni krijimet letrare që s’janë parë si të denja për t’u marrë parasysh nga ata që i diskutojnë seriozisht çështje të tilla, por nga ana tjetër i dëgjon vazhdimisht në radio, bibliotekat janë përplot me to dhe madje reklamohen edhe në muret hoteleve. Pohimi i gabuar që po hedh poshtë është ai sipas të cilit këto krijime pëlqehen nga disa njerëz, po aq sa pëlqehet arti i mirë nga të tjerët, siç ndodh me poezitë e Ella Wheeler Wilcox-it ose me hitin më të fundit popullor në muzikë. Të tilla janë edhe disa lloje posterash por as që bëhet fjalë t’i përfshij.

Sigurisht, s’ka dyshim se këto gjëra pëlqehen në një farë mënyre. Transmetimet radiofonike vijojnë, romanet qarkullojnë, librat poetik blihen. Por a kemi prova që ato zënë në

jetën e dikujt vendin që zë arti i mirë në jetën e atyre që e duan atë? Shikojeni me vëmendje njeriun që shijon muzikë të keqe. Oreksi i tij është vërtet i madh. Është i gatshëm ta dëgjojë muzikën e parapëlqyer me dhjetëra herë në ditë. Por ai jo domosdoshmërisht e ndalon muzikën ndërsa flet me të tjerët. Ai flet dhe dëgjon. Fishkëllen, imiton ritmin duke tundur shputat e këmbëve, vallëzon nëpër dhomë, pi një cigare në tarracë ose tund një shkop sikur të ishte i dirigjentit. Dhe kur të mbaroj muzika, ose edhe para se të mbaroj, do t’ju flasë për diçka tjetër. Them kur muzika që po dëgjon ka mbaruar, kur ka “mbaruar” në një kuptim tjetër, kur ajo këngë ose valle ka dalë jashtë modës, ai kurrë s’mendon më për të dhe në mendoftë ndoshta e bën thjesht nga kureshtja.

Në letërsi, veçoritë e “konsumatorit” të artit të dobët janë edhe më të thjeshta për t’u përcaktuar. Ai (ose ajo) mund të dëshirojë kaq shumë të ketë racionin e përjavshëm të letërsisë së dobët, dhe mund të ndjehet fatkeq nëse kjo i mohohet. Por nuk rilexon kurrë. S’ka dallim më të qartë midis letrares dhe nënletrares. Ky është dallim i pagabueshëm. Arti i mirë letrar

rilexohet, arti i dobët letrar thjesht lexohet. Një roman i sapolëxuar është për ta si gazeta që lexuan dje. Edhe mund të kesh pak shpresë për dikë që s’ka lexuar kurrë Odisenë, Malory-in, Boswell-in, apo Pickwick-un: por s’ka fare (për sa i përket letërsisë) për dikë që ju thotë se i ka lexuar dhe me kaq leximi ka përfunduar një herë e përgjithmonë. Është një lloj sikur një burrë të thoshte se është larë një herë, ka fjetur një herë, e ka puthur një herë gruan, ose se dikur ka bërë një shëtitje. Nëse poezia e dobët rilexohet apo jo (pësha e rëndësës së saj anon në mënyrë të dyshimtë nga dhoma e gjumit) s’e di. Por vetë fakti që s’e dimë është domethënës. Dhe kjo poezi nuk bëhet pjesë e bisedës së atyre që e blejnë librin. Askush s’i dëgjon dy të dashuruar duke cituar vargje apo duke bërë një bisedë të këndshme në muzg për librin e parpëlqyer. Kështu ndodh edhe me pikturën e dobët. Blerësi tregon sinqerisht, pa dyshim, se për të është pikturë e mirë, me ngjyra të ngrohta, e bukur, tërheqëse, ose (me shumë mundësi) thjesht “e këndshme”. Por ai e var aty ku s’mund të shihet dhe s’ia hedh më sytë.

Në gjithë këtë, sigurisht, gjejmë shenjat e një dëshire të vërtetë për artin e dobët, por një dëshirë

që s’është e njëjtë me dëshirën e njeriut për art të mirë. Ajo që dukshëm dëshirojnë dhe marrin klientët e përhershëm të artit të dobët është një mjedis i bukur ku lulëzon jeta, diçka për të mbushur çaste të çuditshme, “pako për bagazhin mendor ose “ushqim të fortë” për stomakun mendor. Në të vërtetë s’bëhet fjalë për çështjen e lumturisë, për përvojë si ajo e prerjes nga tehu i brikut të rrojës, e cila e ribën tërësisht mendjen, dhe shkakton “dridhjen e shenjtët”, duke e formësuar një njeri të ndjehet “vërtet i sëmurë, ashtu siç kam qenë kur dashuroja gruan” siç përshkruhet në ditarët e Samuel Pepys-it. Kënaqësia që merret nga arti i dobët s’është dukuri e cila ndodh në një kontekst të pafat, e njëjtë me kënaqësinë që njeriu merr nga arti i mirë. Dëshira për artin e dobët është dëshirë e lindur nga zakoni, ashtu si dëshira e duhanpirësit për duhan, më shumë e karakterizuar nga gjendje e skajshme e gjendjes së sëmurë se sa nga ndonjë kënaqësi shumë e fortë në përmbushjen e nevojës.

Prandaj, përvojat e para të një gëzimi të vërtetë në arte nuk u shfaqën si përvoja kundërshtare me kënaqësitë e mëparshme të mërzitshme. Kur isha djalosh, nga leximi i “Poema të Romës

antike” të Thomas Babington Macaulay-t (jo të dobëta sa duhet për të shpjeguar çfarë po argumentoj) tek leximi i poemës së Matthew Arnold-it “Sohrabi dhe Rustumi”, s’e kisha fare ndjesinë se po merrja më shumë kënaqësi në aspektin sasior apo cilësor nga sa kisha marrë më parë. Ishte më shumë sikur një dollap rrobash, të cilin deri atëherë e kishe parë si një vend ku vareshin teshat, një ditë bëshesh dëshmitar se pasi të hapësh derën, të çon në kopshin mitologjik të nimfave Hesperides, ashtu si një ushqim që e ke pëlqyer për shijen që ka, një ditë të bën të mundur (si gjaku i dragoit) që të kuptosh këngët e zogjve, ashtu si uji, i cili përveç shuarjes së etjes, befash shndërrohet në pije dehëse. Është sikur të zbulosh se dukuria e vjetër, e njohur si “poezi” mund të përdoret, për një qëllim krejtësisht të ri. Shndërrime të tilla thjesht interpretohen gabim duke thënë se “djalit ka filluar t’i pëlqejë poezia”, ose “ka filluar t’i pëlqejë poezia e mirë”. Ajo që ndodh është se diçka që ka mbetur në sfond si një prej kënaqësive të vogla të jetës, jo krejtësisht e ndryshme nga kafeja, brof përpara teje dhe të mbështjell aq fort sa je “vërtet i sëmurrë”, derisa të rrënqethesh, të ndjesh zjarrin dhe ftohtësinë e acartë të ndjenjave, mus si një dashnor.

Kësisoj, dyshoj se s’duhet të themi se thjesht disave u pëlqen arti i mirë dhe disave arti i dobët. Gabimi këtu fshihet tek folja “pëlqej”. Ndoshta mund të thoni se në frëngjisht fjala “aimer” përdoret për të thënë se një burrë “do” një grua ashtu si “do” golfin dhe mund të provoni t’i krahasoni këto dy “dashuri” për sa i përket “shijes” më të mirë dhe më të keqe. Jemi bërë kështu viktima të një loje fjalësh. Pohimi i duhur është se disa e pëlqejnë artin e dobët, por arti i mirë shkakton një reagim për të cilën “pëlqimi” është fjala e gabuar. Dhe ky reagim, ndoshta, nuk shkaktohet kurrë nga arti i dobët.

Asnjëherë? A nuk ka libra që krijuan tek ne magjepsjen që kam përshkruar (në rini) dhe të cilën ne e gjykojmë si art të dobët? Ka dy përgjigje. Së pari, nëse teoria që po parashtrij funksionon në shumicën e rasteve, ia vlen të merret parasysh dhe të diskutohet nëse përjashtimet e dukshme mund të mos jenë vetëm të dukshme. Ndoshta çdo libër që i ka pëlqyer një lexuesi, sado i ri qoftë, ka ndonjë gjë të mirë në të.



“Kronikat e Narnias” nga C S Lewis

“Ardath” me autore Marie Corelli-in. Edhe në atë moshë, pjesa e fundit i ishte dukur “aq e keqe sa dobësoi përshtypjen e asaj që kisha lexuar më parë”. Por përshtypja e mëershme mbeti. Ndoshta me mençuri zoti Reid s’rrezikoi ta rilexonte librin kur ishte i rritur. Nuk e rilexoi prej frikës se “ajo që më kishte mrekulluar dikur me shumë gjasa do të më dukej krejt e rëndomtë, aventura e zjarrtë do të ngjante si melodramë, poezia si sforcim i pastërtholluar pas efektit të krijuar”. Por sidoqoftë, shton Reid, s’është fare e dobishme “të mëtossh se kënaqësia e dikurshme s’ishte aspak kënaqësi estetike. Ishte. Kjo është e gjithë çështja”, dhe ai jep ndihmesën e tij me sugjerimin e rëndësishëm: “Ajo që lexova atëherë ishte ‘Ardath’ e imagjinatës së zonjës Corelli. Ajo që duhej të lexoja tani do të ishte ‘Ardath’ shumë me më pak shkëlqim se sa arritja e saj e vërtetë letrare”.

Kjo diagnozë mund të mos jetë e saktë. Zoti Reid mund të ketë përvetësuar nga leximi Ardath-n e imagjinatës së autorit, ose mund ta ketë lexuar Ardath-in e vet, domethënë, mund të ketë shijuar një krijim fillestar të vetin nga nxitja e marrë nga libri. Por s’është e nevojshme të vendosësh midis këtyre dy mundësive. Çështja është se, nga ana tjetër, ai po e shijonte librin jo për atë që ishte, por për atë që nuk ishte. Dhe kjo lloj gjëje ndodh shumë shpesh kur lexuesi ka imagjinatë më të fuqishme se autori, sidomos kur është i ri dhe jo kritik ndaj asaj që lexon. Kështu, për një djalë imagjinata e të cilit po njez lulëzimin e parë, përshkrimi më i saktë i tablosë së një anijeje me vela mund të ketë ndikimin e nevojshëm. Në të vërtetë ai vështirë se e sheh anijen. Sakaq është një mijë milje larg, me ujin e kripur në buzë, me bashin që ngrihet e ulet në ujëra, ndërsa pulëbardhat shfaqen për të paralajmëruar se vendi i pazbuluar është afër.

Ajo që s’do ta pranojë është se kjo rrëzon, në përgjithësi, parimin që arti i dobët nuk e ngazëllen kurrë lexuesin. Mund

të rrëzojë zbatimin e gatshëm të këtij parimi si një njësi matëse. Aq më mirë. Ne duam të jemi të sigurt se ekziston një dallim i vërtetë midis artit të mirë dhe të dobët, dhe se zhvillimi i shijes s’përbën një luhajtje pa vlerë. S’është kaq e nevojshme, madje mund të mos jetë jetë e përshtatshme, që ta dimë me siguri, në çdo rast të veçantë, kush është gabim dhe kush ka të drejtë. Ekzistenca e vegimeve (si ajo që, për zotin Reid, nuk erdhi si rrjedhojë, por u mbështet në fjalët e zonjushë Corelli-t) nuk e rrëzon parimin. Tek vegimi, kënaqëmi me atë që nuk ekziston, atë që jemi duke krijuar për veten ose mund të ndodh, kënaqëmi me atë që kujtojmë nga vepra të tjera dhe më të mira për të cilat vepra që po lexojmë bëhet shkas. Dhe kjo është diçka mëse e dallueshme nga masa e madhe e “pëlqimit” ose “vlerësimit” për artin e dobët. Klientët e poezisë sentimentale, romaneve të dobëta, pikturave të këqija dhe melodive thjesht tërheqëse zakonisht shijojnë pikërisht atë që ekziston tek ato. Dhe kënaqësia e tyre, nuk është në asnjë mënyrë e krahasueshme me kënaqësinë që të tjerët

marrin nga arti i mirë.

Arti i dobët s’të magjeps, është i parëndësishëm, i padobishëm, i zakonshëm. As nuk i trazon dhe as nuk i përndjek konsumatorët e tij. Ta quash edhe magjepsjen prej një tragjedie të madhe ose muzikë të elegante, me të njëjtin emër, “pëlqim”, është pak më shumë se lojë fjalësh. Ende mbroj pikëpamjen se arti që të magjeps dhe të mbart brenda tij është gjithmonë i mirë. Në vegime, kjo e mirë s’është aty ku hamendësojmë ne se është, pra, tek libri ose piktura. Por mund të jetë i mirë në vetvete, ashtu si një oaz është gjë e mirë megjithëse ekziston qindra milje larg porse s’është edhe aq larg nëse udhëtari e pikas në luginën përballë. Ende s’kemi prova se cilësitet e pranishme tek arti i dobët mund të bëjnë për këdo atë që bën arti i mirë për disa. Jo sepse arti i dobët jep kënaqësi, por sepse të jep kënaqësi të një lloji krejtësisht tjetër. Le të mos shmangemi nga kryesorja duke shtruar pyetjen nëse dallimi është midis kënaqësisë “estetike” dhe një lloji tjetër kënaqësie. Të dyja llojet e artit ndoshta japin kënaqësi estetike. Çështja është se askush s’i kushton vëmendje artit të dobët në të njëjtën mënyrë si disa i kushtojnë vëmendje artit të mirë.

Nëse është kështu, atëherë s’përballemi me përvoja të kundërta në art midis të cilave duhet të zgjedhim që të formojmë ose jo “një shije të mirë” në nivelin që po diskutoj. Përtej këtij niveli, nëse zhdukim atë që pranohet të jetë art i dobët nga lexuesit që kanë njëfarë aftësie gjykimi kritik, mund të hasim problemin më të vështirë. Ju mund të vendosni që kompozitori francez Hektor Berlioz qëndron më poshtë se Bach-u ose Shelley kundrejt poetit Richard Crashaw. Por unë sugjeroj që çdo vepër e cila ka krijuar njëherë kënaqësi të madhe dhe dalldisëse për dikë – një vepër që ka pasur vërtet rëndësi, ajo ka hyrë brenda rrethit të unazës, dhe se shumica e asaj që ne e quajmë “art

popullor” s’ka qenë kurrë kandidat për të hyrë brenda tij. As s’është përpjekur të hyjë aty, mbrojtësit e këtij lloji arti s’e kanë dashur një gjë të tillë, s’e kanë konceptuar artin e tyre për të hyrë brenda atij rrethi veprash dhe as nuk e kanë synuar.

Në këtë këndvështrim, kriteri i artit të mirë do të ishte thjesht empirik. Nuk ka një test të jashtëm por është kriteri i pagabueshëm. Madje unë do të shkoja më tej. Do të sugjeroja që aftësitë më të mprehta dalluese kritike për ato vepra që janë vetëm brenda rrethit të unazës, përfshijnë gjithmonë (dhe me të drejtë) më shumë se sa kriterin estetik. Kështu ju më thoni se ajo që përjetova kur dëgjova për herë të parë preludin e operas “Parsifal” të Vagnerit qëndron më poshtë se përvoja në dëgjimin e kompozimeve “Muzika e pasionit” të Bach-ut. Jam i sigurt që keni të drejtë. Por s’mendoj se doni të thoni, ose nënkuptoni që arti i Vagnerit është i dobët në kuptimin që muzika shumë popullore është art i dobët. Arti i tij është brenda rrethit të unazës. Meloditë e komedive muzikore, të cilat i këndoja nën zë kur isha djalosh, nuk vlerësoheshin nga unë në të njëjtën mënyrë si vlerësoja “Parsifal-in”. Asnjëherë s’ka pasur qoftë edhe një mundësi që ato të konkurojnë me njëra-tjetrën. Dhe kur ju e quani artin e Vagnerit “të dobët” (në një kuptim shumë më të lartë dhe më të stërholluar) gjithmonë keni parasysh aspekte që janë teknike ose morale të cilat, në qarqe artistike, shpesh maskohen nga ata që i përdorin. Kështu e dënioni Vagnerin si banal, ose si shumë të qartë, sipërfaqësor (të cilat janë aspekte teknike), ose si vulgar, sensual, apo barbar (të cilat janë aspekte morale). Mendoj se mënyra e gjykimit është e drejtë. Vetëm se asnjë prej këtyre kriterëve s’është e nevojshme, ose s’është përdorur për të bërë dallimin paraprak midis artit “real” ose “të mirë” apo “serioz” dhe artit që padyshim është “i dobët” ose (thjesht) “art popullor”. Ky kriter s’ka qenë kurrë konkures. Vagneri është “i mirë” për shkak se mund të bëhet gjëja më e rëndësishme në jetë për një djalë për një vit të tërë ose më shumë. Pas kësaj, vendosni si të dëshironi. “E mira” e këtij arti në kuptimin që po them unë ekziston.

Disa nga këta që hutohen e ngatërrohen s’e kuptojnë dot se si një aksiomë (le të themi, për gjërat që janë barasvlerëse të së njëjtës gjë) mund të pranohet se është e vërtetë. S’do të mund të ishte e tillë nëse për të do të gjendej një pohim të ndër-këmbyeshëm. Por s’ka ndonjë pohim tjetër: ekziston një fjali e cila duket (gramatikisht) si pohim, por s’është e tillë, sepse nëse e shqipton, asgjë s’ndodh në mendjen tënde. Në të njëjtën mënyrë, s’ka asnjë përvojë tjetër si ajo që krijon arti i mirë. Përvoja e krijuar nga arti i dobët nuk është e njëjtë. /Exlibris.al /Përkthet: Granit Zela



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

# Kabashi: Flamurtari nuk ndryshon ndaj Dritës

Veton Kabashi, kapiten i Flamurtarit, për "Epokën e re" ka thënë se skuadra kryeqytetase do të paraqitet ndaj Dritës ashtu siç bëri në xhiron e kaluar kundër Ballkanit. "Drita ka një skuadër mjaft kualitative, por kjo nuk do të thotë se ne shkojmë të dorëzuar në Gjilan. Përkundrazi, do ta shfaqim lojën e njëjtë si kundër Ballkanit dhe të përpigemi të dalim me rezultat pozitiv nga kjo ndeshje", ka thënë Kabashi



dorëzuar në Gjilan. Përkundrazi, do ta shfaqim lojën e njëjtë si kundër Ballkanit dhe të përpigemi që të dalim me rezultat pozitiv nga kjo ndeshje", ka thënë Kabashi. Përhapja e shpejtë në Evropë e COVID-19, i njohur si Corona

**IPKO SUPERLIGA**  
Të shtunën takohen:  
14:00 Drita - Flamurtari  
14:00 Feronikeli - Vushtrria  
14:00 Llapi - Dukagjini

**TË DIEJËN TAKOHEN:**  
14:00 Gjilani - Trepça '89  
14:00 Ballkani - Drenica  
14:00 Prishtina - Ferizaj

Virus, ka bërë që institucionet e Kosovës të marrin masa parandaluese në funksion të mbrojtjes nga ky virus. Këto masa janë marrë edhe në sport, ku aktivitetet sportive do të zhvillohen, por pa praninë e shikuesve. Lidhur me këtë fenomen, Kabashi ka deklaruar: "Sa i përket koronavirusit është mjaft shqetësues sepse shumë kampionate janë pezulluar, por ne po vazhdojmë të luajmë dhe deri kur nuk e di, por mendoj se edhe ne jemi të rrezikuar". Ndeshja në mes të Dritës dhe Flamurtarit zhvillohet sot (e shtunë) nga ora 14:00. Flamurtari aktualisht pozicionohet në vendin e tetë në Superligë më 28 pikë të grumbulluara.

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 13 MARS** - Skuadra e Flamurtarit në tri ndeshjet e fundit në IPKO Superligën e Kosovës në futboll i ka regjistruar dy fitore dhe tri humbje. Njëra prej fitoreve që e arriti skuadra kuqezë e kryeqytetit ishte ndaj skuadrës lidere në elitë, Ballkanit (2-1). Një pjesë të këtij suksesi i takon kapitenit Veton Shabani, i cili është rikthyer në mënyrën më të mirë nga lëndimi. Mbrojtësi ka shënuar golin e vetëm për Flamurtarin në humbjen nga Drenica dhe golin e dytë kundër Ballkanit. "Them të drejtën nuk e kam prit një rikthim kaq të fuqishëm dhe me dy gola të

shënuara. Kam punuar shumë për t'u rikthyer sa ma i fortë, por edhe fati ishte në anën time dhe ia kam arritur qëllimit. Shpresoj se më nuk do të kam problem me lëndime dhe të jap kontribut sa më të madh për klubin që t'i arrijë objektivat në këtë edicion", ka deklaruar Kabashi të premten për "Epokën e re".

Pavarësisht prej fitores ndaj Ballkanit, kapiteni Kabashi kërkon nga shokët e skuadrës një koncentrim maksimal edhe në ndeshjen e radhës në mënyrë që edhe ndeshja në Gjilan të rezultojë e suksesshme për klubin kryeqytetas. "Dihet se edhe Drita ka një skuadër mjaft kualitative, por kjo nuk do të thotë se ne shkojmë të

## Pezullohen aktivitetet sportive për grupmoshat e reja

**PRISHTINË, 13 MARS** - Ministri e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, priti të premten në takim presidentin e Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani dhe disa nga drejtuesit e federatave sportive, kryetarin e FFK-së, Agim Ademi, sekretarin e FFK-së, Eroll Salihu, kryetarin e FHK-së, Eugen Saraçini, kryetarin e FBK-së, Arben Fetahu, sekretarin e FVK-së, Valon Nikqi, dhe sekretarin e FNK-së, Astrit Haliti. Në këtë takim u diskutua lidhur me vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.01/07 të datës 11/03/2020 me



qëllimi të parandalimit të infeksionit Corona Virus COVID-19, ku nga afër u diskutua zbatimi i këtij

vendimi, duke ditur se pjesëmarrja e qytetarëve në fushën e sportit, kulturës dhe rinisë është në masë

të madhe për t'i përcjellë aktivitetet të cilat janë të planifikuara nga organizatat sportive, kulturore dhe rinore sipas agjendave dhe kalendarit të aktiviteteve. "Gjatë këtij takimi u nxorën disa konkluzione si masa parandaluese. Do të pezullohen aktivitetet të grupmoshat e reja sipas procesit të pezullimit në sistemin arsimor (stërvitjet në klube, shkollat e sportit, kuvendet e punës të organizatave sportive dhe tryezat e ndryshme), deri në vendim tjetër nga Qeveria e Kosovës", thuhet në njoftimin e

MKRS-së. Komunitat e Kosovës si masa parandaluese do t'i dezinfektojnë objektet sportive në mënyrë që aktivitetet dhe garat të zhvillohen me numrin e caktuar sipas këtij vendimi. Ministri Dumoshi falënderoj drejtuesit e Komitetit Olimpik dhe të federatave sportive për bashkëpunimin dhe seriozitetin që të kemi vëmendje të shtuar. "Si MKRS do ta vazhdojmë bashkëpunimin me të gjitha organizatat sportive që të merren masa parandaluese", ka thënë Dumoshi.

## Shtyhen dy ndeshjet e Kosovës me Bjellorusinë

**PRISHTINË, 13 MARS** - Janë shtyrë ndeshjet e Përfaqësueses së Kosovës në hendboll në konkurrencë të femrave. Kosova më 25 mars ishte planifikuar ta presë Bjellorusinë në Prishtinë, ndërsa më 29 mars në Minsk është dashur të luhet ndeshja kthyesë. Federata

Evropiane e Hendbollit (EHF) të premten ka vendosur që këto ndeshje të shtyhen dhe të luhen në javën e parë të qershorit. Në fakt, janë shtyrë të gjitha ndeshjet kualifikuese të xhiros së tretë dhe të katërt që është dashur të luhen më 25\26 mars dhe 28\29 mars.

"Federata Evropiane vendosi që t'i shtyjë të gjitha ndeshjet kualifikuese, por edhe ndeshjet e tjera evropiane të hendbollit. Nuk do të luhen ndeshjet evropiane të hendbollit deri më 12 prill. Ky vendim është marrë në kuadër të masave për ta parandaluar përhapjen e

koronavirusit. Tani ndeshja e ardhshme e hendbollisteve të Kosovës është ajo ndaj Sllovenisë që do të luhet më 27 maj në Prishtinë. Më 31 maj është ndeshja Gjermani - Kosovë, ndërsa në javën e parë të qershorit duhet të luhen dy ndeshjet me Bjellorusinë. Janë



këto ndeshje të fazës së dytë eliminatorie për 'Euro 2020', thuhet në njoftimin e Federatës së Hendbollit të Kosovës.

## Toverlani: Na mungon përkrahja e tifozëve, por në fushë e japim maksimumin

**DRENAS, 13 MARS** - Trajneri i FC Feronikelit, Afrim Toverlani, ka folur për faqen e klubit nga Drenasi para ndeshjes së të shtunës ndaj skuadrës së Vushtrrisë. Ai e ka theksuar edhe

faktin e mungesës së tifozëve si masë parandaluese e qeverisë ndaj pandemisë së koronavirusit, por që kjo nuk do të ndikojë në dhënien e maksimumit në fushë. "Ndeshjes do t'i

qasemi me seriozitetin më të madh si ndaj çdo kundërshtari tjetër. Me Vushtrrinë luajtëm edhe para një jave dhe ishte ndeshje e fortë, shpresojmë ta përsërisim rezultatin e njëjtë në

favorin tonë. Luajmë si vendës, por do të jemi pa praninë e tifozëve. Na mungon përkrahja e tifozëve, sidoqoftë në fushë do ta japim maksimumin", ka thënë Toverlani.



## Ndërpriten ligat më të forta evropiane të futbollit

**NYON, 13 MARS** - Ishte thjesht e pashmangshme, por tashmë vjen dhe konfirmimi zyrtar: UEFA ka vendosur ta ndërpresë Ligën e Kampionëve dhe Ligën e Evropës për ta shmangur përhapjen e Covid-19 ndërmjet lojtarëve. UEFA ndërpret ndeshjet e kthimit në dy garat më të forta, gjithashtu as shorti i programuar për më 20 mars nuk do të hidhet. Ky vendim i UEFA-s hyn në fuqi menjëherë, ndërsa do të vendoset në një kohë kur do të rifillojnë aktivitetet evropiane për klube. Pas rasteve të fundit në Itali, ku kanë rezultuar pozitiv Rugani dhe Gabiadini dhe pas rasteve të fundit në Premierë Ligë, ku pozitivë kanë rezultuar trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta dhe futbollisti i Chelsea, Hudson-Odoi, ky vendim i UEFA-s ishte i pashmangshëm. Ekipet si Juventus, Manchester City, Real Madrid dhe Inter janë futur në karantinë duke e bërë të pamundur pjesëmarrjen e tyre në fushën e lojës. Në kushte emergjence, UEFA tashmë është e detyruar të ndryshojë dhe kalendrar çka prek drejt për drejt edhe "Euro2020". Për momentin në tavolinë janë dy opsione, të



zhvillohet në vjeshtë ose të shtyhet për në 2021. Pas Italisë, Spanjës, Francës, tashmë është radha e Anglisë për ta pezulluar futbollin. Sipas raportimeve të fundit të mediave britanike, është rëndë dakord që futbollit të pezullohet deri në datën 4 prill. Ky vendim ishte i pritshëm, pasi në Premierë Ligë numërohen plot pesë klube që janë future në karantinë. Bëhet fjalë për Arsenalin, Chelsea, Evertonin, Leicester Cityn dhe Burnemouthin. Në këtë situatë alarmante, si pasojë e përhapjes me shpejtësi të Coronavirusit, futbollit dhe sportet e tjera në

përgjithësi janë ndalur. Janë pezulluar të premtën edhe ndeshjet e kampionatit gjerman në futboll. Vendimi që vlen për ndeshjet e Bundesliga 1 dhe Bundesliga 2 është marrë pasdite nga Liga Gjermane e Futbollit (DFL). Fillimisht ishte pritur që ndeshjet e Bundesligës të luhen këtë fundjavë. Vetë Bundesliga kishte propozuar që masa e pezullimit të hyjë në fuqi të martën. Por përhapja e mëtejme e koronavirusit ka bërë që ai propozim të hedhet poshtë. Të premtën pasdite është vendosur që edhe ndeshjet e Bundesligës të pezullohen deri më 2 prill.

## Skuadrat kryesuese ndajnë mejdantin në basketboll

**PRISHTINË, 13 MARS** - Në fundjavë do të zhvillohet xhironja e 28-të e Superligës së Kosovës në basketboll, ku takimet do të zhvillohen pa shikues dhe me një numër të caktuar të zyrtarëve të ndeshjeve. Takimi i parë është në mes të Feronikelit dhe Golden Eagle Yllit. "Nikli" ka pesë fitore dhe 19 humbje, derisa Ylli 16 fitore dhe tetë humbje. Sfidë interesante pritet ndërmjet Pejës dhe Ponte Prizrenit. Pejanët janë në formë të mirë, ku renditen në vendin e katërt me 15 fitore dhe nëntë humbje, derisa Prizreni është në vendin e gjashtë me 13



fitore dhe 11 humbje. Derbi i kësaj xhiro është Sigal Prishtina - Rahoveci, që zhvillohet të dielën në kryeqytet. Prishtina ndodhet në vendin e parë me 42 pikë, një më shumë se Rahoveci. Në garat e Superligës këtë edicion, "vreshtarët" kanë triumfuar tri herë ndaj prishtinasve, derisa këto dy skuadra janë ballafaquar

edhe në finale të "Play-off"-it, Kupës dhe Superkupës, ku në tri garat fituan prishtinasit. Kjo xhiro do të përmbyllet me ndeshjen Lipjani - Bashkimi. Lipjanasit kanë dy fitore dhe 22 humbje, duke u renditur në vendin e fundit, kurse prizrenasit kanë 15 fitore dhe nëntë humbje. Trepça pushon në këtë xhiro.

### SHKURT

#### Dënohen Ballkani, Drita dhe Prishtina

Skuadra e Ballkanit nga Suhareka është dënuar me 1 200 euro nga Komisioni Disiplinor i Federatës së Futbollit të Kosovës. KD-ja ka konstatuar se skuadra e Ballkanit ka bërë lëshime në organizimin e ndeshjes ku shikuesit kanë ndezur mjete piroteknike dhe kanë hedhur të njëjtat në fushë, kurse tifozët vendës në kor e kanë ofenduar lojtarin e Dritës, Liridon Leci. Ndërsa skuadra e Dritës është dënuar me 1 500 euro, pasi tifozët e kësaj skuadre "Intelektualët" në ndeshjen ndaj Prishtinës kanë ndezur mjete piroteknike tymuese dhe shurdhuese disa nga të cilat i hedhur në fushë. Dënimit nuk i ka shpëtuar as Prishtina, pasi "Plisat" kanë ndezur mjete piroteknike - flakadanë dhe shurdhuese në tribuna, prej të cilave 5 copë i hedhur në fushë. Zyrtari i Llapit, Muhamet Rexhepi, është dënuar me dy ndeshje për kryerjen e të gjitha detyrave në klub. Ndërsa Trepçës '89 dhe Ferizajt i është shqiptuar vërejtja e fundit.

#### Ndërroi jetë anëtari i 'Plisave', Lekë Bulliqi

Anëtari i "Plisave", Lekë Bulliqi, ndërroi jetë të premtën. Ai ishte qëlluar të enjten me armë zjarri në lagjen Arbëria në Prishtinë, ndërsa fatkeqësisht nuk ka arritur t'u mbijetojë plagëve. Tifozët "Plisat" përmes një postimi në rrjetet sociale e kanë kujtuar shokun e tyre, i cili nuk iu nda asnjëherë Prishtinës dhe ngjyrave "bardhekaltër". Bulliqi ishte në të kaluarën edhe lojtar i 2 Korrikut.

#### Pas Australisë, shtyhen edhe dy gara të tjera në Formula 1

Edicioni i vitit 2020 në Formula 1 pritet të startojë vetëm në fund të majit, është bërë e ditur të premtën. Pasi të enjten u mor vendimi që të anulohet gara e parë e edicionit, ajo e Australisë, të premtën janë shtyrë dy gara të tjera. Për shkak të përhapjes globale të koronavirusit, është vendosur që të shtyhen garat në Bahrejn dhe në Vietnam. Gara për shpërblimin e madh të Bahrejnit është dashur të mbahet nga 20 deri më 22 mars, kurse ajo në Vietnam prej 3 deri më 5 prill. "Si rezultat, Formula 1 dhe FIFA presin që kampionati të fillojë në Evropë në fund të majit, por gjendja do të përcillet vazhdimisht", thuhet në njoftimin e F1.

#### Dybala: Nuk jam me koronavirus, jam në izolim

Sulmuesi i Juventusit, Paulo Dybala, ka mohuar thashethemet se ai ka dalë pozitiv ndaj Covid-19. "Përsëritet të gjithëve, vetëm për të konfirmuar që jam mirë dhe në izolim vullnetar. Faleminderit të gjithëve për mesazhet dhe shpresoj të jeni mirë", ka shkruar Dybala. Mbrojtësi Daniele Rugani doli pozitiv ndaj Covid-19 dy ditë më parë duke bërë që e gjitha skuadra bardhezi dhe stafi të vetizoloheshin, duke përfshirë madje dhe presidentin Agnelli.

#### Fekiri, në 'radar' të Realit

Real Madridi po planifikon transferimin e yllit të Real Betisit, Nabil Fekir. Sipas mediumit "fichajes.net", roli kryesor i francezit në fitoren 2-1 të Betisit kundër Real Madridit thjesht ka shtuar interesin. 26-vjeçari ka shënuar shtatë gola dhe ka siguruar tri asistime në 23 ndeshjet e tij për Betisin që nga kalimi i tij në verë nga klubi francez, Olympique Lyonnais. Fekir mund të jetë i disponueshëm për 25 milionë euro këtë verë për "Los Blancos", të cilët mund të përfshijnë Dani Ceballosin në çdo marrëveshje të tillë.

#### SUPERLIGA - JAVA 28

Të shtunën takohen:  
17:00 Feronikeli - Golden Eagle Ylli  
19:00 Peja - Ponte Prizreni

Të dielën takohen:  
17:00 Sigal Prishtina - Rahoveci  
19:00 Lipjani - Bashkimi  
Trepça (pushon)



<b>Autor:</b> <b>GAZMEND MORINA</b>	KËNGËTARJA NË FOTO	MONOPOLIZIMI	PJESË E DHOMËS	BUJK	GAS INSTITUTE TECHNOLOGY	METODË STUDIMI	MENDJEHOLLË	<b>EPOKA E RE</b>	MBATHËSE SPORTIVE (sh.shq.)	BAR PËR TË DALË JASHTË	SHKOP I BILARDOS												
NJË LLOJ SHPATE JO SHUMË E MADHE								PËRFUNDIM NË SHAH															
VEGËL MUZIKORE								MA JEP															
ANIJATAT VEÇORI THELBËSORE E NJË SENDI								JO ÇIFT MES I TRUPIT TË NJERIUT															
					I LUHATSHËM NË QËNDRIME MBIZOTËRIM						QËLLIM I PARAMENDUAR (shq.)												
ISH SHEFI I OSBE-së NË KOSOVË ... EVERTS				SHTYLLË E DRUNJTË, TRA AKTORI ÇELAJ							SHKRONJA XV KORNIZË												
FLORI				LUAJ NAIM OSMANI				NJOLLA FUTBOLLISTI FRANCEZ DIARRA															
I SHKALLËS MË TË ULËT A I ÇAKUT MË TË POSHTËM											GOTË PREJ METALI FLOKU ARTIFICIAL												
	KEQTINGËLLIM	PORTIERI SPANJOLL ANTONIO (R. MADRID)	SHTET NË AZI	PRESIA E SOTME	DJALI KUNDREJT PRINDËRVE TË VET (pashq.)	HYJNIA E DASHURISË (mit. romake) ALYSSA MILANO		ANTON PASHKU KLUB FUTBOLLI NË ITALI			DY BASHKËTINGËLLORE MJET KOMUNIKIMI												
NJERINGRËNËSI											ISLANDA TANTAL, SULFUR												
ANËTARËSIM NË NJË ORGANIZATË (shq.)											SABOTAZH												
PARADHËNIE						GJON, NJË SHPËND GRABITQAR DRITA E VETURËS					BANOR I KRËEQYTETIT TË FILIPINEVE LËRE (bised.)												
BASKETBOLLISTI TURK OMER ....					PËRFUNDIMTAR KËNGËTARJA KRASNIQI (shq.)			LAKIMI MARC ANTHONY															
FRANCA		LLOJ VEGLE MUZIKORE KALLI MISRI QË RUHET PËR FARË (shq.)				OSAKA HEROI ... KUKA					SOLISTJA ... BYTYQI TRAJNERI ITALIAN .... SAKI	ANA FARIS REPERI ..... AGUSHI (shq.)	BASHKËTANI										
KLUB FUTBOLLI NË GREQI "... CRETE"				ERA E KËNDSHME BODRUM I PJEVE (sh.shq.)							TENISTJA KURNIKOVA IVREA		TRAJNERI GJERMAN REHAGEL PËRËMËR PRONOR										
NANTES, ANGERS													I DËRGUARI SPECIAL PËR ZGJIDHJEN E NJË KONFLIKTI KËNGËTARJA ... KOÇI	DYERT E THURURA ME THUPRA DY BASHKËTINGËLLORE									
AKTORJA CAHANI													ISH ATLETJA MERLIN DUKATI	MUZIKANTI KRASNIQI LUTJET NË TË CILAT PRIFTI SHPREH DISA DËSHIRA		NJË E RESHUR KUVENDI I KOSOVËS							
ELEKTRODA E POLIT POZITIV NË NJË BURIM RRYME QË S'KA TJETËR TË NGJASHËM ME TË: QË TAKOHET SHUMË RRALLË, E VETME													SHENJË QË MENDOHESET PARALAJMËRON DIÇKA TË MIRË A TË KEQE	KLUB FUTBOLLI NË SUEDI REGJISORI MINAROLLI		MOLDE MËNJOLLË, NJOMËZ							
I NJËSUAR, I BASHKUAR													VRIMË SHUMË E VOGËL NË DIÇKA GJENERALI YNË VESELI	ALLEN NURI PRODUKT I PULËS		KLUBI I FUTBOLLIT QË NUK I PËRKËT FESË DHE KLERIT	KAFSHË SHTËPIAKE						
NAIM ISMAJLI																	E FILLOVE SERVER NAME INDICATION	KËNGËTARJA KANADEZE LAVIGNE "G" NË MES TË DY "E"		ILAZ KODRA MENDIM			
ZANORE																	MJET PËR TË RRËSHQITUR MBI BORË AGIM POSHKA	VARGJET KURANORE POSTA DHE TELEKOMI		KËNGËTARJA BARAKU BASHKËT.			
QYTETI FRANCEZ I FILMIT																		VENDI I OPRUAR QË NUK ËSHTË MBYLLUR ENDE ZANORE			FUTBOLLISTI ERIK ..... (Barcelona) ZANORE		
MBIEMRI CILËSOR																						GAZ I PANGJYRË DHE I PA ERË	SHTET NË AFRIKË (pashq.)



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo  
Trepça - Shoqëri Aksionare  
Trepça - Deoničarsko Društvo  
Trepça - Joint Stock Company



Adresa: Parku industrial Mitrovicë, Tel. 028/538 050, 531 135, Fax: 028/539 202 web: www.trepçacorporation.org  
Address: Mitrovica Industrial Park. Tel. 028/538 050, 531 135, Fax: 028/539 202 web: www.trepçacorporation.com

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës, nenit 22 paragrafi 4 të Statutit të Trepça Sh.A, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik dhe nevojave të paraqitura për plotësimin e vendit të lirë të punës, Trepça Sh.A me dt. 14.03.2020 rishpall:

## Konkurs

### Pozita: Dy (2) Zyrtar për Prokurim

Kohëzgjatja e emërimit: e përhershme

#### a). Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhon dhe organizon punën dhe aktivitetet e prokurimit dhe siguron që të gjitha procedurat e prokurimit të zhvillohen në harmoni me ligjet dhe rregulloret e prokurimit;
- Planifikon, koordionon dhe përgatit aktivitetet vjetore të prokurimit në ndërmarrje, bashkëpunon me personat përgjegjës të ndërmarrjes lidhur me hartimin e planit të prokurimit, kërkesave për prokurim dhe analizon të arriturat, vështirësitë, kufizimet, etj nga aspekti i prokurimit;
- Bënë analiza, vlerësime dhe identifikon nevoja të reja me qëllim të realizimit të aktiviteteve të ndërmarrjes;
- Është përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe akteve të tjera nënligjore të aplikueshme në Kosovë;
- Vendos në dosje dhe arkivon të gjithë dokumentacionin e zyrës së prokurimit;
- Harton raporte javore, mujore, tremujore dhe vjetore për të gjitha aktivitetet e prokurimit me të cilat është ngarkuar;
- Kryen dhe detyra të tjera të caktuara nga mbikëqyrësi;
- Mbron vlerën e organizatës duke ruajtur informacionin konfidencial.

#### b). Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara;

- Diploma universitare, fakulteti ekonomik apo juridik;
- 2 vite përvojë pune profesionale ;
- Të jetë i çertifikuar për prokurim;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e prokurimit, ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit, shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

#### Dokumentet përcjellëse si vijon:

- Dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i)
- Letërnjoftimi kopje
- Çertifikatën nga gjykata që nuk është i dënuar
- Dëshminë e përvojës së punës

Formulari i aplikacionit duhet të merret në Divizionin e burimeve njerëzore, ndërtesa e Menaxhmentit të Trepça Sh.A, Parku Industrial Mitrovicë, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri 16:00, ndërsa dorëzimi i formularit së bashku me dokumentacionin e kërkuar duhet të paraqitet në email adresën [contact@trepçacorporation.com](mailto:contact@trepçacorporation.com).

Dokumentacioni i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm. Afati i konkurimit është 8 dita nga shpallja e këtij konkursi.

Për informata shtesë, ju lutem telefononi në numrin: 028/538-050.

Mitrovicë

Trepça Sh.A  
Kryeshefi Ekzekutiv

Basri Ibrahim

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Ndërmarrja Banesore Housing Company”, SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me NRB: 70170420. Nr fis: 600525747 dhe me nr. Unik: 810241365, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditore nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Ndërmarrja Banesore Housing Company” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 70170420. Nr fis: 600525747 nr. Unik: 810241365, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Ndërmarrja Banesore Housing Company” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 70170420. Nr. fis: 600525747 and nr. Unik: 810241365 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “BIFPRO TEK”, SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik: 811379298, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditore nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “BIFPRO TEK” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: nr Unik: 811379298 , ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “BIFPRO TEK” L.L.C. has come to the decision to quit its business: Unik: 811379298 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA DRENAS/GLOGOC  
Zyra e Personelit  
01Nr: 1169-13752 dt. 13/03/2020

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1, nenit 18, paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit nr.04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit nr.03/L-068 Për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 3 paragrafi 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr.15/2019 për Detyrat, Përgjegjësitë, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zv.Drejtorit të Institutit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar, Sektori i Burimeve Njerëzore, Komuna Drenas/Glogoc, shpallë:

### KONKURS PËR PLOTËSIMIN E POZITËS SË PUNËS

#### DREJTORIA E ARSIMIT

L'itulli i vendit të punës: Drejtor Shkolle të Mesme të Lartë (SHML)  
Gjimnazi „Gj.K. Skënderbeu” - Drenas

Lloji i vendit të punës: Me mandat  
Numri i Pozitave: 1 (një) pozitë  
Kategoria Funksionale: Nivel drejtues  
Koefficienti: 8,4  
Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet

#### Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

#### DETYRAT KRYESORE TË PUNËS:

- Menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit;
- Hartimin e planit vjetor të punës dhe planit zhvillimor të institucionit, të cilin e miraton Këshilli drejtues i shkollës;
- Kordinimin dhe bashkëpunimin me aktivet profesionale për ndarjen e normave dhe orëve për mësimdhënës/edukatorë, caktimin e kujdestarëve të klasave, kujdestarëve të ditës si dhe kërkim raportim prej tyre;
- Caktimin e detyrave për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet të tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë edukativo-arsimor, konform legjislacionit në fuqi si dhe caktimi dhe shqiptimi i masave ndaj nxënësve;
- Mentorimin dhe monitorimin e orëve mësimore si dhe vlerësimin e përfundimit të mësimdhënësve dhe stafit tjetër administrativ-teknik, në mënyrë objektive, për çdo vit shkollor, duke e vendosur një kopje të këtij vlerësimi në dosjen e secilit punëtor dhe përgaditë një raport të përgjithshëm me rekomandime për DKA-në;
- Pjesëmarrjen në panelin për pranimin e kuadrit në shkollë;
- Nxjerrjen e vendimeve për themelimin e komisioneve të ndryshme në interes të shkollës;
- Kryerjen e detyrave tjera të ngarkuara nga ana e DKA-së dhe obligimet e përcaktuara me akte tjera normative.

#### Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshëm për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore;
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit;
- Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim e noterizuar ose e vërtetuar;
- Të kenë 5 vite përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit;

#### Aplikacioni duhet të përmbajë:

- Dokumentet personale (certifikatën e lindjes dhe letërnjoftimi ose pasaporta);
- Diplomën e kualifikimit (ose certifikat) e noterizuar ose e vërtetuar;
- Certifikatat e trajnimeve të përfunduara;
- Dëshmi se ka licencë të mësimdhënësit ose që është në procedurë të licencimit;
- Dëshmi të përvojës së punës në arsim;
- Portfolion profesional (sipas udhëzimeve në shtojcën G të UA 08/2014);
- Letër reference nga një institucion publik-kredibil (si MASHT, DKA, Këshilli Drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë). Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprakë;
- Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues për të cilin konkuron (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fontit i shkronjave Arial madhësia 12) sipas udhëzimeve të MASHT;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore e kandidatit - origjinale;
- Dëshminë se nuk është nën hetime - origjinale.

Data e rishpalljes së konkursit 14/03/2020 deri me dt. 28/04/2020

Aplikacioni për konkurim merret në zyrën e DKA-së, kati i parë, sporteli nr. 10-12, Formularët të plotësuar rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit. Dokumentacioni i kompletuar, dorëzohet në arkivin komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit të konkurimit nuk do të shqyrtohen. Konkursi mbetet i hapur 15 (pësemëdhjetë) ditë nga data e shpalljes në në shtypin ditor dhe në medie elektronike.



Zyra e Personelit  
Anumshahë Shabani

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Loma Family” Sh.p.k Gorazhdec, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e fabrikës për përpunim dhe konservim të mishit në Gorazhdec komuna e Pejës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 10.04.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant “Ujëvara e Drinit” në Radafc komuna e Pejës do të organizohet debat publik nga kompania “Loma Family” Sh.p.k Gorazhdec, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e fabrikës për përpunim dhe konservim të mishit në Gorazhdec komuna e Pejës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

Fatlume Shabani

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbresa Teatri, 4 Kullat, Rr. Bajram Kelmendi

Salloni i Depilimit ‘Lume’s Details’ në Prishtinë kërkon një praktikante e cila pastaj mund të punësohet me pagesë nëse tregon rezultat të mirë gjatë kohës së praktikës.

Të interesuarat mund të paraqiten në këta numra kontaktues:  
045681898 dhe 044900978



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada - Government

**Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit**

**Ministarstvo Infrastrukture i Sredine - Ministry of Infrastructure and Environment**

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë  
për Kushtet Ndërtimore**

**“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Nr. prot: 7114/19 të datës 06.12.2019, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mia-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor

Suzana.goranci@rks-gov.net

Telefon: + 381 38 200 32 553



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada - Government

**Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit**

**Ministarstvo Infrastrukture i Sredine**

**Ministry of Infrastructure and Environment**

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë  
për Kushtet Ndërtimore**

**“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Nr. prot: 6003/19 të datës 07.10.2019, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mia-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor

Suzana.goranci@rks-gov.net

Telefon: + 381 38 200 32 553

"ALL PRODUCTIONS AP" sh. p. k. me NRB: 811338715

**Shpall:**  
**NJOFTIM MBI SHUARJEN E BIZNESIT**

Me këtë njoftim mbi shuarjen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "ALL PRODUCTIONS AP" SH.P.K. me seli ne Skenderaj Rr. 28. Nëntori dhe pronat Blerim Geci, njoftojmë të gjitha bizneset dhe personat fizik të cilët kanë ndonjë pretendim të mundshëm për ndonjë borxh apo të ngjashëm ne "ALL PRODUCTIONS AP" sh.p.k. të paraqesin pretendimet e mundshme të argumentuara në mënyrë që ne tu përgjigjemi kërkesave të juaja. Duke filluar nga dt. 12.03.2020. ky njoftim do të jete i publikuar në gazetën ditore "Epoka e Re" dhe afati i pritshëm për ndonjë pretendim do të jete nja muaj ditë.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► N.T.P “Ef-Menagment” shpall të pavlefshëm certifikatën e biznesit me numër: 70880156.

► Besmir Zhegrova B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 71039889.

► Shemi Muhadri B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit D.P.Z. “Muhadri” me nr. 810402347.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Shaban Musliu, shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të -I- të shkollës së mesme teknike “Arkitekt Sinani” në Mitrovicë.

► Albana Pacaj shpall të humbur diplomën e Fakultetit të Mjekësisë- Departamenti Infermieri në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.

► Rrustem Shaban Kosumi, shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Elena Gjika” në Prishtinë.

► Shpallet e pavlefshme certifikata e biznesit “Ndërmarrja e Re, Lavertaria-Blektoria “Toka Bujqësore”- Lubizhdë Sh.p.k, me numër të regjistrimit të biznesit: 70801388.

► Dafina Shabani nga Prishtina, shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme “Xhevdet Doda” në Prishtinë.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen “Mati 1” Rr. “Muharrem Fejza”, banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen “Mati 1” rruga “Muharrem Fejza” Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen “Mati 1” përball “Super Vivës”, me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpeite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpeite)

# AUTOSHKOLLA RITMI

044 248 173  
045 626 123  
044 648 122

**PRISHTINË**

[autoshkollaritmi@gmail.com](mailto:autoshkollaritmi@gmail.com)



Në prag të 5, 6, 7 dhe 8 Marsit ditëve të lavdisë dhe sakrificës së familjes Jasharaj, ditës së mësuesit dhe ditës së nënës, për kandidat/etë interesuar për regjistrim të marrjes së patentë shoferit ofroj lehtësim financiar. **Vijimi i orëve praktike dhe teorike për 20 ore nga 200.00 Euro në 150.00 Euro.**

**Interesimi i juaj - përkushtimi ynë. Eksperienca jonë - suksesi i juaj. Afati i paraqitjes prej 02.03. 2020 deri më 20.03.2020**

